



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe”

Tiranë, shkurt 2025

P Ë R M B A J T J A

1	PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT.....	5
1.1	Konteksti i problemit social.....	5
1.2	Rëndësia e auditimit të performancës.....	6
1.3	Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	6
2	SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM.....	7
2.1	Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
2.2	Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	12
2.3	Rëndësia e produkteve të subjektit.....	12
2.4	Pesha në buxhet.....	13
2.5	Përkufizimet dhe terminologjia.....	16
2.6	Skema e analizës së programit auditues.....	17
2.7	Feedback-u i subjektit gjatë auditimit.....	18
3	DETAJET E AUDITIMIT.....	19
3.1	Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	19
3.2	Objektivi i auditimit.....	20
3.3	Pyetjet e auditimit.....	21
3.4	Fushëveprimi i auditimit.....	22
4	SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE.....	23
4.1.1	A garantojnë dokumentet politike dhe kuadri ligjor e rregullator miradministrimin e hapësirave publike në plazhe?	23
4.1.2	A janë procedurat e përcaktuara në funksion të përdorimit efektiv të hapësirave publike në plazhe?	27
4.2.1	A përmbushin hapësirat publike në plazhe interesat e qytetarëve?	30
4.2.2	Si ka evoluar ecuria e të ardhurave të vjela nga dhënia në përdorim e hapësirave publike në plazhe?	34
4.2.3	A është efektiv procesi i monitorimit dhe inspektimit të hapësirave publike në plazhe?	43

Lista e shkurtimeve

Shkurtimi	Emërtimi i plotë
RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MSHMS	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
ARB	Agjenci Rajonale e Bregdetit
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
DPZHT	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit
PPB	Prodhimi i Përgjithshëm Bruto
INSTAT	Instituti i Statistikës
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
PINBB	Plani i Integruar Ndër sektorial për Brezin Bregdetar
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
SKZHQT	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
SWOT	Fuqitë, Dobësitë, Shanset, Kërcënimet

PËRMBLEDHJE

Auditimi me temë “Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe” ka pasur si objektiv kryesor vlerësimin e vizionit politikëbërës mbi menaxhimin e hapësirave publike në plazhe dhe mekanizmit të ngritur për administrimin dhe menaxhimin e tyre, duke synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse politikat e ndërmarra, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve janë të qarta, strukturat e përshtatshme, si dhe proceset administrative garantojnë menaxhim efektiv të hapësirave publike në plazhe.

Institucionet subjekt i këtij auditimi kanë qenë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe bashkitë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë.

Nga auditimi i ushtruar rezultoi:

Shqipëria është i vetmi vend në rajon dhe Mesdhe që vazhdon të mos ketë të miratuar një ligj për menaxhimin e integruar të bregdetit, dhe strategji për menaxhimin e vijës bregdetare. Plazhet janë pronë publike në administrim të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV) bregdetare, ndërsa procedurat për dhënien e hapësirës publike në plazhe subjekteve përfitues, kryhen në nivel qendror. Procesi i hartëzimit të zonës bregdetare nga ana e bashkive bregdetare, për përcaktimin e parcelave të plazheve është një proces formal, i cili nuk pasqyron ndryshimet e mundshme në terren.

Të gjitha bashkitë subjekt auditimi nuk kanë krijuar struktura të veçanta të cilat të kenë përgjegjësi funksionale menaxhimin e plazheve si në sezonin zyrtar të plazhit ashtu edhe në periudhë përgatitore apo pas përfundimit të këtij sezoni, si dhe gjatë planifikimit të treguesve të buxhetit nuk ka një zë të veçantë të planifikuar të shpenzimeve për periudhën që zhvillohet aktiviteti turistik i plazhit.

Raporti 30% hapësirë e lirë për publikun nuk është trajtuar me përparësi dhe nuk është i vërtetueshëm në terren, pasi ai aplikohet në një territor të përgjithshëm, dhe jo specifik për çdo zonë plazhi. Hapësira e dedikuar për plazh publik, e cila administrohet nga bashkitë nuk përmbush të gjitha standardet e përcaktuara. Tarifat për zënien e hapësirës publike nuk janë rishikuar nga ana e bashkive nëpërmjet analizave ekonomike, me synim rritjen e të ardhurave të arsyetueshme. Të ardhurat e vjela nga dhënia e hapësirës publike në plazhe nuk përdoren në mënyrë direkte për menaxhimin e tyre. Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve të përfshira në menaxhimin e hapësirave publike në plazhe, sjell për pasojë mungesën e një vizioni të qartë dhe të qëndrueshëm në kohë.

Në përfundim, rezulton se mungon një menaxhim i integruar i plazheve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe politikave të turizmit.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i Problemit Social

Plazhet në Shqipëri përfaqësojnë një nga asetet më të çmuara natyrore të vendit. Vija bregdetare që shtrihet në një gjatësi prej rreth 450 kilometrash përgjatë detit Adriatik dhe Jon, me plazhe të ndryshme nga veriu në jug, që variojnë nga tipologjia me rërë kurative deri në brigje me guralecë dhe ujë kristalor, e bëjnë bregdetin shqiptar një atraksion i fuqishëm për turistët vendas dhe të huaj. Ato nuk janë vetëm një atraksion turistik i rëndësishëm, por gjithashtu një burim i çmuar për mirëqenien e komuniteteve lokale.

Kritika të shumta ka pasur vitet e fundit, pasqyruar edhe në media lidhur me çmimet e larta që aplikohen në hapësirat publike që ju jepen subjekteve private, për çadra e shezlongë dhe hapësirave të limituara dhe jo të përshtatshme për plazhet publike. Kroacia për kontratat e koncesionit dikton çmimin maksimal të shezlongeve në mënyrë që koncesionarët të mos vendosin arbitrarisht çmime të larta¹. Koncesionet private për plazhet publike në Kroaci jepen sipas kushteve të Ligjit për Pronat Detare dhe Portet Detare.²

Greqia me rishikimin e ligjit në fillim të vitit 2024 përcaktoi të paktën 50 për qind e plazhit duhet të mbetet pa çadra dhe shezlongë dhe sipërfaqja totale e çdo koncesioni nuk mund të kalojë 500 m². Sipas legjislacionit të ri, shkeljet në lidhje me aksesin në plazhet publike penalizohen me gjoba deri në 60,000 euro.³

Ndërkohë Shqipëria mbetet i vetmi vend në Evropë, të cilit i mungon një ligj për bregdetin, ku të përfshihej dhe trajtimi i plazheve, në ngjashmëri me vendet bregdetare të rajonit.

Situata e deritanishme në plazhe paraqitet e rënduar, e konfirmuar edhe nga raportet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (AKB) dhe institucione të tjera qendrore, çka e bën emergjente miratimin e një kuadri rregullator ligjor dhe menaxherial për bregdetin, i cili do të trajtonte me përparësi plazhin si burim turistik-ekonomik për Shqipërinë. Ngritja e task forcës apo grupeve monitoruese për çdo sezon turistik, duke angazhuar një numër të lartë institucionesh janë tregues të një menaxhimi jo të mirë të plazheve, përpos cenimit të imazhit turistik nga këndvështrimi i pushuesit. Në disa plazhe, infrastruktura është e pamjaftueshme, duke përfshirë mungesën e rojeve bregdetare, tabelave sinjalizuesve, kabinave për ndërrim, dushe të pastra dhe tualet të mirëmbajtur. Kjo ndikon negativisht në përvojën e vizitorëve dhe mund të krijojë shqetësim në komunitet ku hapësirat publike nuk kanë cilësinë e duhur ose në disa raste nuk ka hapësirë të mjaftueshme për shfrytëzim nga publiku. Problemet e pastrimit janë gjithashtu një sfidë e dukshme. Fluksi i lartë i turistëve gjatë sezonit të verës shpesh kalon kapacitetin e strukturave dhe shërbimeve ekzistuese, duke e bërë më të vështirë menaxhimin e mbeturinave dhe mbajtjen e plazheve të pastra.

Në përfundim hapësirat publike në plazhe kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit dhe mirëqenien sociale, të drejtën e çdo qytetari për të patur akses në plazh publik në çdo zonë ose kryesisht në zonat historike ku është frekuentuar nga banorët e zonës. Ato hasin sfida të shumta që kërkojnë zgjidhje dhe përmirësime të vazhdueshme. Por me investime të duhura dhe një menaxhim më të mirë, plazhet mund të realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe të kontribuojnë në një të ardhme më të ndritshme për komunitetet dhe vizitorët e tyre.

¹ <https://balkaninsight.com/2017/07/12/no-consensus-on-guests-rights-on-croatia-s-beaches-07-11-2017/#:~:text=This%20notes%20that%20all%20beaches,infrastructure%20that%20the%20concessioner%20built.>

² <https://balkaninsight.com/2017/07/12/no-consensus-on-guests-rights-on-croatia-s-beaches-07-11-2017/#:~:text=This%20notes%20that%20all%20beaches,infrastructure%20that%20the%20concessioner%20built.>

³ <https://neës.gtp.gr/2024/03/01/greek-laëmakers-take-action-to-protect-public-beach-access/>

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti i programeve qeveritare.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, KLSH ndërmori auditimin “Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe”, duke e konsideruar si një ndër çështjet e ndjeshme dhe aktuale në kushtet e dinamikave të reja dhe vizionit të qeverisë për zhvillimin e turizmit në vend. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me politikat e ndërmarra, si dhe mënyrën e administrimit dhe menaxhimit të hapësirave publike në plazhe nga institucionet përgjegjëse. Në përfundim jepen rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur, në shërbim të taksapaguesve dhe qytetarëve të vendit tonë.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij audituese gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për shëndetin e qytetarëve si në nivel qendror ashtu edhe në nivelin e ofruesve të shërbimit, me synim sigurimin dhe garantimin e të drejtës themelore të shtetasve për shërbime shëndetësore të aksesueshme dhe cilësore.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar një sërë auditimesh pranë subjekteve nën auditim. Disa prej tyre si më poshtë:

Auditim i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit Tiranë dhe Agjencitë Rajonale Lezhë, Durrës, Pogradec, Vlorë dhe Sarandë, Vendim nr. 83 i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 12.07.2021” për auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në AKB, mbi vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, për periudhën e vitit 2020 dhe në raste identifikimi risku në periudhën e mëparshme 2016-2019”.

Vendim nr. 213 i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 28.12.2023 “ Për auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në AKB”.

Gjetjet dhe konkluzionet e dokumentuara për këto auditime janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe degët Rajonale
3. Bashkia Shkodër
4. Bashkia Lezhë
5. Bashkia Durrës
6. Bashkia Vlorë
7. Bashkia Himarë
8. Bashkia Sarandë


Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është ministria përgjegjëse për turizmin dhe ka këto detyra:

- zbaton parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e industrisë turistike;
- harton dhe paraqet për miratim, pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, Planin Kombëtar të Turizmit dhe përgjigjet për zbatimin e tyre;
- harton dhe paraqet për miratim, pranë Këshillit të Ministrave, strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe planin e veprimit;
- mbështet, mbron e zhvillon burimet turistike dhe promovon produktet turistike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe në bashkëpunim me grupet e interesit;
- nxit, mbështet dhe bashkëpunon me institucione publike dhe private në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave në fushën e turizmit.⁴
-

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Turizmit, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme për Zhvillimin e Turizmit është struktura përgjegjëse për hartimin e dokumenteve politikë në fushën e turizmit. Kjo strukturë është organizuar vetëm në nivel drejtorie pa sektorë të tjerë mbështetës.

Figura 1. Organigrama e MTM dhe institucionet e varësisë.



Burimi MTM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

⁴ Ligji Nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.

Disa nga detyra kryesore të DPZHT janë:

- ✓ Hartimin, zhvillimi dhe zbatimi i politikave, programeve dhe projekteve zhvillimore në fushën e turizmit.
- ✓ Koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të tyre për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit përmes respektimit të trashëgimisë dhe mjedisit, duke punuar me të gjithë aktorët.

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Turizmit ndjek:

Zhvillimi i politikave të turizmit, koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të tyre dhe zhvillimi i mëtejshëm i kornizës ligjore lidhur me politikat dhe strategjitë e zhvillimit të turizmit, produkti i turizmit, investimet, statistikat, etj.

- Implementimi i Strategjisë së Turizmit, në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe kombëtare planin e territorit.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit

Është një institucion në varësinë e ministrit përgjegjës për turizmin. AKB ka për mision mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrolli e veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.⁵

AKB-ja ka këto kompetenca/përgjegjësi:


- a) Sigurimin e performancës në zonat bregdetare;
- b) Organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- c) Organizimin e punës për nxitjen e investimeve në zonën bregdetare;
- ç) Organizimin e punës për bashkërendimin e programeve, të projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- d) Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike.

AKB-ja organizohet në dy nivele: a) në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore; b) në nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) agjencive rajonale.⁶

⁵ Vendim nr. 569, datë 17.7.2019 për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të bregdetit.

⁶ Vendim nr. 569, datë 17.7.2019 për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të bregdetit., kap.III, pika2

Figura 2. Organizimi i AKB në nivel rajonal, nëpërmjet Agjencive Rajonale të Bregdetit



Burimi AKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

AKB-ja, në përputhje me kompetencat/ përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

- ✓ Merr pjesë në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre;
- ✓ Propozon ndryshime dhe përmirëson kuadrin ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- ✓ Monitoron zbatimin me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare;
- ✓ Kontrollon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi Inspekton dhe kontrollon zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;
- ✓ Merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit.⁷

Figura 3. AKB Organigrama e strukturës përgjegjëse për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe.



⁷ Vendim nr. 569, datë 17.7.2019 për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të bregdetit., kap.III, pika 6

Drejtoria e Performancës, Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare dhe Standardeve në Turizëm, pranë AKB ka këto detyra:


- ✓ Koordinon procesin e monitorimit dhe zbatimit me përpikmëri të instrumenteve të menaxhimit të integruar të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore dhe vendore në zonën bregdetare; Siguron realizimin e detyrave të parashikuara në planet mujore dhe vjetore të punës së drejtorisë, drejton analizat e punës duke evidentuar problemet që dalin, merr masa për zgjidhjen e tyre, si dhe sugjeron dhe propozon zgjidhje tek Drejtori i Përgjithshëm;
- ✓ Propozon ndryshime dhe përmirëson kuadrin ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- ✓ Merr pjesë në hartimin e rregullores për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike, të cilat zhvillohen në zonat bregdetare;
- ✓ Merr pjesë në hartimin e rregullores së posaçme, ku përcaktohen standardet kombëtare, sipas të cilave administrohen hapësirat publike të zonës bregdetare, që përdoren si plazhe publike apo të administruara nga subjektet private.

Agjencitë Rajonale të Bregdetit

Agjencitë rajonale të bregdetit kryejnë këto detyra:

- ✓ Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;
- ✓ Marrin masa, vendosin gjoha/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit;
- ✓ Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi.

Figura 4. Organigrama e Agjencie Rajonale të Bregdetit



Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë

Sa i përket formës së organizimit të bashkive Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë, asnjë prej tyre nuk ka të parashikuar një strukturë të dedikuar për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe.

Çdo vit nëpërmjet një urdhri të kryetarit të bashkisë, ngrihet një grup pune për hartimin e propozimit të hartës së plazheve të lejuara për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit. Gjithashtu po me një urdhër të kryetarit të bashkisë ngrihet një grup pune në zbatim

të detyrimeve të përcaktuara në rregulloren për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit.

Njësitë vetëqeverisëse kanë si kompetence në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe ministrinë përgjegjëse për turizmin, të përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara.

- a) hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari si stacion plazhi;
- b) hapësirat e plazhit publik;
- c) vendndodhjen e kullave dhe pikave të vrojtimit;
- ç) zonën e çadrave;
- d) zonën e shërbimeve;
- dh) hapësirën ujore të lejuar për notim (zonë e rrethuar me bova);
- e) vend bazimit e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre;
- ë) zonat rekreative etj.

Harta e përgjithshme përgatitet nga një grup pune i drejtuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në përbërje të së cilës ka përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe miratohet, brenda muajit janar, me vendim të këshillit bashkiak.

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

2.2.1 Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji Nr. 93/2015 Për Turizmin⁸, (ndryshuar me Ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017, nr. 101/2018, datë 13.12.2018; nr. 30/2024, datë 4.4.2024), (i përditësuar).
- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
- Plani i Integruar Ndër sektorial për Brezin Bregdetar.
- Të tjera.

2.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit

- Ligji nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 569/2019 “Për funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, i ndryshuar.
- Vendim Nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, (ndryshuar me VKM nr. 424, datë 27.5.2020; nr. 1172, datë 24.12.2020; nr. 827, datë 24.12.2021; nr. 659, datë 10.10.2022), (i përditësuar).
- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Të tjera.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Qëllimi i ligjit 93/2015 “Për turizmin” është të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt, dhe duke respektuar nevojat e

⁸ Ky ligj është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me Aneksin e Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, “Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve”, si dhe me nenin 2 dhe nenin 3 të Rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit nr. 692/2011/BE, datë 6 korrik 2011, “Statistikat Evropiane në Turizëm”.

komuniteteve pritëse të sotme dhe të brezave të ardhshëm.

Drejtimet kryesore të politikës shtetërore në fushën e turizmit, që bazohen te parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, janë, si më poshtë:

- njohja e turizmit si sektor me përparësi i ekonomisë;
- mbështetja e veprimtarive turistike dhe krijimi i kushteve të favorshme ligjore, ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tyre;
- përcaktimi i drejtimeve me përparësi për zhvillimin e turizmit në Shqipëri;
- krijimi i imazhit të Republikës së Shqipërisë si destinacion turistik;
- krijimi i kushteve për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të turistëve e të ofruesve të shërbimeve të turizmit;
- zhvillimi dhe mbështetja e turizmit pritës.

Nga njëra anë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucioni përgjegjës për politikat e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit e cila nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, i implementon dhe kryen gjithë procesin e monitorimit dhe inspektimit në terren përgjatë gjithë vijës bregdetare. Në anën tjetër janë NJVQV që shtrihen në vijën bregdetare, të cilat disponojnë si aset të tyre hapësirat publike në plazhe, nga dhënia në përdorim e të cilave vjelin tarifa të konsiderueshme.

2.4 Peshë në buxhet

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucion qendror, i cili propozon politika dhe zbaton programin qeverisës në fushën e turizmit dhe financohet nga Buxheti i Shtetit.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit është person juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin.

AKB financohet nga:

- Buxheti i Shtetit
- Donacione
- Burime të tjera të ligjshme

Buxheti i AKB-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për turizmin⁹

Buxheti i AKB akordohet në total, nuk ka fonde të dedikuara për hapësirat publike në plazhe, as në kuadër të inspektimit ose monitorimit. Për çdo vit ushtrimor AKB i alokohet një fond i veçantë për shërbimin e pastrimit të vijës bregdetare.

Tabela nr. 1 Fonde buxhetore të alokuara për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit periudha 2022-2024

		Viti 2024		Viti 2023		Viti 2022	
Emërtimi	Kodet	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Monitorime te kryera përgjatë gjithë vijës bregdetare	92603AB	81,079,185	58,453,530	88,279,185	85,564,970	59,488,247	58,122,101
Shërbimi i pastrimit	92603AF	250,000,000	0	194,840,000	167,388,282	103,700,000	103,576,496
Totali		331,079,185	58,453,530	283,119,185	252,953,252	163,188,247	161,698,597

Burimi AKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

⁹ Vendim nr. 569 datë 17.07.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKB-së”

AKB në nivel rajonal është e organizuar nëpërmjet 4 agjencie.

Tabela nr. 2 Fonde buxhetore të alokuara për Agjencitë Rajonale të Bregdetit periudha 2022-2024

Njësia

	2022		2023		2024	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Agjencia Rajonale Durrës	5,881,000	5,167,283	8,460,000	8,051,707	10,900,000	7,914,908
Agjencia Rajonale Lezhe	5,653,000	4,664,785	8,763,000	8,307,479	10,900,000	5,278,651
Agjencia Rajonale Sarande	4,190,000	2,701,220	3,160,000	2,470,320	10,900,000	5,111,980
Agjencia Rajonale Vlore	6,049,000	5,180,378	7,660,751	7,187,751	10,900,000	6,068,336
Totali		17,713,666		26,017,257		24,373,875

Burimi AKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga:

- taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore;
- fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit ;
- fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare;
- huamarrja vendore;
- donacionet;
- burime të tjera të parashikuara në ligj.¹⁰

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë.¹¹

Njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin tarifa për zënien e hapësirës publike¹²

d) për zënien e brigitëve ujore për biznes dhe qëllime të tjera;

Nga të dhënat e raportuara nga bashkitë subjekt i këtij auditimi të ardhurat e vjela nga tarifa për zënien e hapësirës publike në plazhe, për periudhën 2022-qershor 2024 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 3 Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirës publike në plazhe (fakt) për periudhën 2022-qershor 2024

Njësia

Nr.		2022	2023	2024	Totali
1	Bashkia Shkodër	89,229,000	107,803,000	75,491,000	272,523,000
2	Bashkia Lezhe	53,732,523	51,903,097	58,916,660	164,552,280
3	Bashkia Durrës	113,201,214	106,300,645	96,382,582	315,884,441
4	Bashkia Vlore	38,537,270	43,759,360	53,651,620	135,948,250
5	Bashkia Himare	88,887,000	112,114,360	108,006,150	309,007,510
6	Bashkia Sarande	63,315,900	57,729,600	79,036,100	200,081,600
	Totali				

¹⁰ Ligj Nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Neni 10

¹¹ Ligj Nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Neni 14


¹² Ligj Nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Neni 15, pika 1

		446,902,907	479,610,062	471,484,112	1,397,997,081
--	--	--------------------	--------------------	--------------------	----------------------

Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Ecuria e të ardhurave nga vjelja e tarifës për zënien e hapësirës publike në plazhe paraqet në përgjithësi tendencë në rritje për periudhën 2022-2024.

Grafiku 1. Paraqitja grafike të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirës publike sipas bashkive (fakt) për periudhën 2021-qershor 2024



Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH


Siç vihet re edhe nga grafiku të ardhurat e vjela nga tarifa për zënien e hapësirës publike në Bashkinë Durrës kanë një tendencë ulje.

Në vitin 2022 janë realizuar të ardhura në masën 113.201.214 lekë.

Në vitin 2023 janë realizuar të ardhura në masën 106.300.645 lekë.

Në vitin 2024 (deri në qershor) janë realizuar të ardhura në masën 96.382.582 lekë.

Grafiku 2. Paraqitja grafike e peshës specifike që zënë në totalin e të ardhurave, të ardhurat nga tarifat për zënien e HPP sipas bashkive për gjithë periudhën 2022-qershor 2024.



Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Sikundër shihet edhe nga grafiku i mësipërm të ardhurat e vjela nga secila bashki kundrejt totalit të ardhurave prej 1.397.997.081 lekë, për gjithë periudhën 2022- qershor 2024 rezulton si më poshtë:

Bashkia Vlorë në vlerën 135.948.250 lekë ose rreth 10% e totalit të ardhurave.

Bashkia Lezhë në vlerën 164.552.280 lekë ose rreth 12% e totalit të ardhurave.

Bashkia Sarandë në vlerën 200.081.600 lekë ose rreth 14% e totalit të ardhurave.

Bashkia Shkodër në vlerën 272.523.000 lekë ose rreth 19% e totalit të ardhurave.

Bashkia Himarë në vlerën 309.007.510 lekë ose rreth 22% e totalit të ardhurave.

Bashkia Durrës në vlerën 315.884.441 lekë ose rreth 23% e totalit të ardhurave.

Të ardhurat më të larta realizohen nga bashkitë Himarë dhe Durrës, ndërsa niveli më i ulët i të ardhurave nga Bashkia Vlorë.

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

“*Turist*” është vizitori që qëndron, të paktën për një natë, në vendin që viziton për pushim, biznes dhe qëllime të tjera.

“*Turizëm*” është tërësia e veprimtarive të personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë, për jo më shumë se 1 vit, në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm, për pushim, biznes dhe qëllime të tjera që nuk kanë lidhje me ushtrimin e ndonjë veprimtarie të paguar në vendin që vizitohet.

“*Turizëm i qëndrueshëm*” është turizmi që përmbush nevojat e turistëve, të komuniteteve pritëse, të sipërmarrjeve turistike dhe të vendimmarrësve lokalë e qendrorë, nëpërmjet menaxhimit të burimeve turistike, ruajtjes së vlerave të vazhdueshme ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, me qëllim që ato të mbeten po aq tërheqëse sa më parë dhe të krijohen mundësi për zhvillimin e turizmit në të ardhmen.

“*Turizëm kombëtar*” nënkupton turizmin vendas dhe turizmin në dalje.

“*Turizëm ndërkombëtar*” nënkupton turizmin në dalje dhe turizmin pritës.

“*Turizëm vendas*” është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori rezident brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

“*Stacion plazhi*” është veprimtari turistike e ushtruar në struktura të ndodhura pranë bregut të detit, të liqeneve ose lumenjve, të pajisura me kabina për plazh, dhoma zhveshjeje, shërbime higjienike, duše që, sipas rastit, ofron shërbimin e ushqimit dhe pijeve.

“*Plazh*”, zona me rërë, zhavorr apo shkëmb, që shtrihet në buzë të ujit të detit, lumit apo liqenit, e cila është pronë ekskluzive e shtetit dhe administrohet nga njësi e vetëqeverisjes vendore, e hapur për përdorim të lirë publik dhe që është identifikuar si e përshtatshme për zonë çlodhjeje, argëtuese e që konsiderohet e parrezikshme nga pikëpamja shëndetësore apo e sigurisë për përdorim nga pushuesit.

“*Plazh i lejuar*”, ato plazhe që janë identifikuar sipas shtojcës 1, të kësaj rregulloreje, ku lejohet të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit sipas kushteve dhe kritereve të kësaj rregulloreje.

“*Rregullore e detajuar e stacioneve të plazhit*”, tërësia e rregullave të detajuara që përfshin procedurat për përzgjedhjen e subjektit dhe rregullat për vendosjen e pajisjeve, objekteve dhe lehtësirave të tjera në funksion të tipologjisë së plazhit, e cila i bashkëngjitet kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit. Modeli i rregullores së detajuar të stacioneve të plazhit miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

“*Plazh publik*”, zona të plazheve të lejuara dhe të administruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të hapura për përdorim publik e që ofrojnë kërkesa minimale për sigurinë dhe higjienën.

“*Vrojtues plazhi*”, personi i kualifikuar dhe i certifikuar nga qendrat e formimit profesional për vrojtues plazhi, për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e parë mjekësore.

“Buxhet” është tërësia e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, miratuar nga këshilli i njësive të vetëqeverisjes vendore.

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore” janë bashkitë dhe qarqet, të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

“Programi buxhetor afatmesëm” është parashtrimi për tre vjet i planeve të shpenzimeve të buxhetit vendor, nëpërmjet lidhjes së drejtpërdrejtë të programeve me veprimtaritë, produktet, objektivat dhe qëllimet e politikës.

“Taksë vendore” është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësive të vetëqeverisjes vendore.

“Tarifë vendore” është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.


“Të ardhura nga burimet e veta” janë të gjitha të ardhurat që krijohen dhe administrohen në nivel vendor, nën autoritetin e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Ky auditim do të fokusohet në analizimin e politikave për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe, sistemin administrimit dhe menaxhimit të tyre, kontrollin, monitorimin si edhe rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë pasur duke u fokusuar veçanërisht në:

- Vizionin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe.
- Hartimin e politikave që garantojnë mirë administrimin dhe përdorimin e hapësirave publike në funksion të zhvillimit të turizmit dhe qytetarëve.
- Rolin dhe përgjegjësinë që kanë strukturat që administrojnë dhe menaxhojnë.
- Ecurinë e të ardhurave të vjela nga përdorimi i hapësirave publike në plazhe.
- Sistemin e raportimit, kontrollit dhe monitorimit të hapësirave publike dhe aktorët e përfshirë.

Fig. 5 Skema e analizës së programit auditues



2.6 Feedback-u i subjektit në fazën e terrenit

Gjatë fazës së terrenit, subjektet nën auditim, i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese si edhe i janë përgjigjur jo në të njëjtën mënyrë plotësimi të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, që lidhet me vjeljen e të dhënave shteruese. Përgjigjet e pyetësorëve të fazës së terrenit nga ana e subjekteve, kanë qenë të

pjesshme, jo të plota, çka ka bërë që deri në saktësimin e të dhënave të kërkuara të ketë pasur komunikim të vazhdueshëm. Bashkia Vlorë nuk i është përgjigjur plotësisht kërkesave të grupit të auditimit gjatë fazës së terrenit.

Vlen të theksohet gatishmëria e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, gjatë gjithë periudhës së auditimit në lidhje me kërkesat e grupit të auditimit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit


Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në veprimtarinë e subjekteve nën auditim, që lidhen me fushën e menaxhimit të hapësirave publike në plazhe. Analiza SWOT është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizajnuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. Për kryerjen e analizës grupi i auditimit ka përcaktuar objektivin që synohet të arrihet përmes këtij auditimi, ka mbledhur të dhëna dhe evidenca dhe ka bashkërenduar mendimet dhe konceptet e secilit prej anëtarëve të grupit.

U përzgjedh përdorimi i analizës SWOT nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e mirë menaxhimit të çështjes së trajtimit të hapësirave publike në plazhe nga institucionet përgjegjëse.

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Fig.6 Analiza SWOT



Burimi: Grupi i auditimit

Tabela. 4: Analiza e Riskut


Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Mungesa e Ligjit për bregdetin.	Risk Strategjik	I lartë
2	Mungesa e përditësimit të kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore.		I lartë
3	Mungesa e strukturave të dedikuara për menaxhimin e HPP pranë NJVQV.		I lartë
4	Mungesa e ushtrimit të plotë të funksioneve të NJVQV në procedurat e përzgjedhjes së subjekteve.		I lartë
5	Mungesë e planifikimit të fondeve buxhetore për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe.	Risk Financiar	I lartë
6	Mospërdorimi i të ardhurave të vjela nga dhënia e HPP në funksion të mirëmbajtjes dhe garantimit të standardeve.		I lartë
7	Mungesë analize kosto përfitim në nivel qendror dhe vendor.		I lartë
8	Mungesa e përditësimit të kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore.	Risk Rregullator dhe Juridik	I mesëm
9	Numri i lartë i institucioneve të përfshira në procesin e menaxhimit dhe monitorimit të HPP.	Risk Operacional	I mesëm
10	Mungesë e trajtimit me përparësi të hapësirës publike në procesin e hartëzimit të plazheve.		I lartë
11	Mungesë e transparencës me publikun.		I mesëm
12	Mungesë e profesionit të vrojtuesit të plazhit.		I mesëm

Burimi: Grupi i Auditimit

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe” ka si objektiv kryesor vlerësimin e vizionit politikë bërës mbi menaxhimin e hapësirave publike në plazhe dhe mekanizmit të ngritur për administrimin dhe menaxhimin e tyre. Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse politikat e ndërmarra, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve janë të qarta, strukturat e përshtatshme si dhe proceset administrative garantojnë menaxhim efektiv të hapësirave publike në plazhe.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka pasur si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi politikat e ndërmarrja dhe miradministrimin e proceseve me synim garantimin e të drejtës qytetare për akses dhe përdorim të hapësirave publike në plazhe. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij ka pasur një qasje në nivel qeverisje qendrore, duke parë nga perspektiva e detyrimeve që subjektet kanë në lidhje me menaxhimin e hapësirave publike në plazhe por edhe në nivel vendor duke qenë se këto hapësira administrohen nga NJVQV.

Periodha e audituar është 01.01.2022 deri në 30.09.2024. Gjatë këtij auditimi jemi fokusuar në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkive Sarandë, Himarë, Vlorë, Durrës, Lezhë, Shkodër. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhur si edhe periudha e auditimit prej vitit 2022 është zgjedhur për të pasur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit në këndvështrimin e politikave të hartuara për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe, procedurave të ndjekura si dhe veprimtarinë që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të përmbushjes së objektivave.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

Pyetja Kryesore: Si menaxhohet hapësira publike në plazhe?

MESAZHI I AUDITIMIT

Mungesa e një strategjie kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit, mungesa e kuadrit ligjor për t'i dhënë status juridik të veçantë zonës bregdetare (edhe pse problematikë e evidentuar prej vitesh), cenon efektivitetin e mekanizmit të ngritur për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe. Mbivendosja e funksioneve të disa institucioneve që kanë role të ngjashme ose mbivendosja e veprimtarisë së tyre në disa aspekte si mbikëqyrja e cilësisë së shërbimeve, inspektimi për higjienën etj., mund të shkaktojë dublim të procedurave, ose procese të panevojshme me pasoja në cilësinë e shërbimit.


Raporti 30% i plazheve publikë ndaj sipërfaqes së plazheve, nuk është trajtuar me përparësi dhe është i pavërtetueshëm në terren, pasi aplikohet mbi gjithë sipërfaqen territoriale të plazheve dhe jo e ndarë për çdo zonë. Plazhet e dedikuara për publikun nuk plotësojnë standardet e përcaktuara në VKM-së 171/2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, lidhur me sigurinë dhe cilësinë e tyre. Iniciativat për ndryshime në kuadrin ligjor dhe rregullator të hapësirave publike në plazhe nuk bazohen në analiza kosto përfitim dhe studime, për pasojë rezultojnë struktura të munguara në bashkitë bregdetare, tarifa për zënien e hapësirës publike të parishikuara prej vitesh, mungesë fondesh të dedikuara për menaxhimin e plazheve, mungesë koordinimi mes institucioneve, struktura të cunguara dhe jo të përshtatshme për monitorimin dhe inspektimin e tyre. Vlerësimi i situatës aktuale të plazheve dhe mekanizmit të ngritur për menaxhimin e tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse, do të siguronte një qasje publike të drejtë dhe të qëndrueshme në plazhe dhe një mundësi të mirë për të përmbushur potencialin e plotë turistik të këtyre zonave në funksion të taksapaguesve dhe qytetarëve shqiptarë.

4.1 A ka një vizion të qartë mbi menaxhimin e hapësirave publike në plazhe?

4.1.1 A garantojnë dokumentet politikë dhe kuadri ligjor e rregullator miradministrimin e hapësirave publike në plazhe?

Mungesa e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të bregdetit cenon garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të zonës bregdetare si edhe sigurimin e mbrojtjes së saj.

Figura 7. Brezi bregdetar



Burimi: AKB

Bregdeti shqiptar përfaqëson një nga zonat më të rëndësishme të territorit, për shkak të pozicionit, vlerave natyrore, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore e historike që përmban. Dinamika e zhvillimeve me ritme të shpejta, nuk ka lënë hapësira për studime të mirëfillta në këtë zonë, të cilat do t'i paraprinin zhvillimit strategjik të saj, për të vendosur në funksion të zhvillimit pozitën e rëndësishme gjeografike në shkallë rajonale, si edhe për të përdorur me mençuri dhe përshtatshmëri burimet e shumta natyrore, kulturore dhe njerëzore. Gjatësia e vijës kufitare të Shqipërisë është 1094 km, nga të cilat 316 km janë vijë bregdetare. Vija bregdetare shqiptare karakterizohet nga një larmi për sa i takon tipologjisë së bregdetit, plazheve që ofron, si shkëmbore ashtu edhe fushore, relievit dhe tipareve kulturore tradicionale, e lidhur kjo edhe me karakteristikat e ndryshme në florë, faunë dhe elemente të trashëgimisë¹³.

Shqipëria aderon në Konventën e Barcelonës “Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe”, ratifikuar në vitin 2000 me Ligjin Nr. 8690, datë 16.11.2000

¹³ https://planifikimi.gov.al/index.php?id=pins_bregdeti

“Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe”, si dhe 6 Protokollat shoqëruese”. Në vitin 2010 pranohet një protokoll tjetër i Konventës së Barcelonës, miratuar me Ligjin nr. 10 234, datë 18.2.2010 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të Konventës së Barcelonës “Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Rajoneve Bregdetare të Mesdheut”. - Konventa e Barcelonës, i detyron palët që të sigurojnë përdorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare, në mënyrë që të ruajnë habitatin natyral të bregdetit, burimet natyrore dhe ekosistemet.¹⁴

Me gjithë detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare, rezultojnë se mungon planifikimi i integruar i zhvillimit të sektorëve që lidhen me menaxhimin e bregdetit, rregullave për ushtrimin e një sërë aktivitetesh ekonomike përgjatë bregdetit, rezultat i së cilës mund të jetë një zhvillim kaotik i turizmit në këtë brez, duke kufizuar potencialin e tij dhe si rrjedhojë, edhe perspektivën ekonomike për një kategori të gjerë të popullsisë. Agjencia e Kombëtare e Planifikimit të Territorit, ka prezantuar Planin e Integruar Ndër sektorial për Bregdetin, i miratuar me vendim të KKT në vitin 2016, i cili si në strukturë ashtu edhe në përmbajtje ka karakter përshkrues dhe jo menaxherial e planifikues, pasi mungojnë objektivat dhe plani i veprimit për arritjen e tyre si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij plani.

Sidoqoftë, kuadri ligjor ekzistues nuk garanton një qasje të integruar për zhvillimin dhe mbrojtjen e plazheve. Vendimet e deritanishme rregullojnë më shumë çështje operative, si vendosja e stacioneve të plazhit dhe certifikimi i strukturave akomoduese, duke vendosur kufizime për ndërtimet në vijën bregdetare dhe duke detyruar një listë fikse çmimesh për shërbime si shezlongët. Përkundër këtyre rregulloreve, mungon një ligj i plotë dhe i posaçëm për bregdetin, i cili do të përcaktonte qartë se si hapësirat publike duhet të përdoren, mbrohen dhe administrohen, duke përfshirë dhe zgjidhjen e problematikave të përvetësimit apo shfrytëzimit in formal të plazheve nga subjektet private.

Aktet rregullatorë nuk garantojnë të drejtën e qytetarëve për akses të lirë në plazhe, duke inkurajuar masivizimin e stacioneve private të plazhit që rezultojnë në jetë burim informalizimi edhe për të ardhurat vendore.

I vetmi akt rregullator që trajton aksesin në plazhe është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019, Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, i shfuqizuar gjatë periudhës së auditimit, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024.

Hartimi dhe miratimi gjatë periudhës së auditimit, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024, erdhi si rrjedhojë e problematikave të hasura në terren në procesin e administrimit të stacioneve të plazhit dhe hapësirës bregdetare, problematika këto të trajtuara nga grupi i auditimit në të gjitha takimet që janë zhvilluar me subjektet objekt auditimi.

Ndër problematikat që u evidentuan nga auditimi në terren, mund të listojmë mos identifikimi i qartë i hapësirës së plazheve publike apo keq pozicionimi i plazheve publike në raport me zonat e shërbimit përgjatë vijës bregdetare, çka i kthen ato në zona më pak të pëlqyeshme duke ulur cilësinë e ofertës që turistët marrin në plazhin publik. Pozicionimi i margjinalizuar i plazheve publike përgjatë vijës bregdetare, në rastet kur nuk shërbehet siç duhet nga ana e njësisë të vetëqeverisjes vendore sjell vështirësi në aksesueshmëri, prezencë të lartë mbetjesh dhe mungesë pajisjesh në pikat e vërtetimit të vijës bregdetare.

Problematike kanë qenë edhe rastet e evidentuara ku hapësirat e plazheve publike janë zënë ose përvetësuar në mënyrë informale, apo edhe përdorimi i tyre në mënyrë abuzive nga

¹⁴ https://planifikimi.gov.al/index.php?id=pins_bregdeti

subjekte të peregjistuara apo pa kontratë për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, raste këto të evidentuara nga grupet e monitorimit dhe inspektimit të AKB-së.

Tashmë me zgjerimin e listës për llojet e strukturave të cilat mund të aplikojnë për certifikim, ky vendim ndihmon gjithashtu procesin e formalizmit të sektorit të akomodimit dhe e kthen administrimin e stacioneve të plazhit në një sektor mbështetës në funksion të shtimit të shërbimeve të ofruara nga strukturat akomoduese. Certifikimi i strukturave akomoduese është i nevojshëm për hartëzimin e ofertës akomoduese që Shqipëria ofron si edhe për identifikimin e cilësisë së kësaj oferte.

Vendosja e sinjalistikës së detyrueshme si edhe lista fikse e çmimeve për shezlongë shman problematikën e abuzimit me çmimet dhe e bën më të lehtë monitorimin e situatës së çmimeve në territor.

Shtimi i hapësirave publike dhe rritja e cilësisë së plazheve publike është efekti kryesor që ky vendim synon të arrijë. Mirë pozicionimi i segmenteve të plazheve publike do të rrisë cilësinë e plazhit të ofruar për qytetarët pa pagesë duke rritur sigurinë për pushuesit si dhe nivelin e higjienës në hapësirat e plazhit publik.

Ky vendim gjithashtu synon të rrisë gjithë përfshirjen e pushtetit vendor dhe angazhimin e tij të plotë në menaxhimin e territorit të tij bregudor. Kjo qasje rrit gjithashtu angazhimin qytetar në respektimin e hapësirave publike në momentin që ato mirë evidentojnë si të tilla.

Specifikimi i kushteve teknike sipas tipologjisë së plazheve lehtëson zbatimin në terren të rregullores. Detajimi i kushteve dhe kriterëve teknike ndihmon procesin e monitorimit dhe në rast mosrespektimi marrjen e masave administrative përkatëse. Identifikimi i qartë i strukturave akomoduese apo strukturave të shërbimeve si menaxhues të stacioneve të plazhit sjell gjithashtu reduktimin e in formalitetit në ofrimin e tyre si shërbime mbështetëse.

Lidhur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024, për sa i përket proceseve vendimmarrëse mbi miradministrimin e plazheve, duhet të ishte më transparent ku të përfshiheshin në konsultime qytetarët dhe palët e interesuara për të pasur një miradministrim të qëndrueshëm dhe në interes të komunitetit.

Megjithëse ekzistojnë një sërë aktesh ligjore që prekin sferën e menaxhimit të plazheve, ato nuk përbëjnë një kuadër rregullator të posaçëm. Vlen për t'u theksuar se në ligjin nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, koncepti i plazhit dhe i bregdetit si burim turistik nuk është i rregulluar, duke mos i dhënë rëndësinë e duhur politikave të turizmit drejt forcimit të kapaciteteve turistike të bregdetit shqiptar. Një nga të metat e identifikuara të menaxhimit të bregdetit në Shqipëri konsiston në faktin se dispozitat rregulluese janë të shpërndara në një sërë aktesh ligjore, mes organeve të ndryshme të dy pushteteve të ndryshme, atij vendor dhe qendror.

Nga analizimi në tërësi i kuadrit ligjor, konstatohet se menaxhimi i plazheve është i fragmentarizuar në një sërë dispozitash ligjore, por nuk është i konturuar në një ligj të vetëm. Për pasojë, ende nuk ekziston një menaxhim i integruar i plazheve, çka sjell mos shfrytëzimin e tyre si aset turistik. Në strukturën aktuale të menaxhimit të plazheve vërehet jo vetëm mungesë e efience por nuk janë krijuar as premiset për një menaxhim të qëndrueshëm të plazheve orientuar drejt objektivave të turizmit.

Praktikat e mira që vijnë prej vendeve, si Greqia dhe Spanja, i japin vëmendje të veçantë mbrojtjes së bregdetit, duke e garantuar nëpërmjet një regjimi juridik të posaçëm. Greqia nëpërmjet ligjit për bregdetin dhe plazhin, ka vënë theksin e ndalimit të ndërtimeve pranë zonës së plazheve si dhe ka parashikuar rregullime sa i takon dhënies me qira. Ndërkaq Spanja e ka ngritur mbrojtjen e bregdetit dhe plazheve, si pronë publike në nivel kushtetues.¹⁵

¹⁵ Neni 132, pika 2 e Kushtetutës Spanjolle,

http://www.congreso.es/portal/page/portal/Congreso/Congreso/Hist_Normas/Norm/const_espa_texto_ingles_0.pdf

Në këtë këndvështrim, lind e nevojshme ndërmarrja e një nisme ligjore, duke pasur parasysh vlerën ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të mjedisit të zonës bregdetare, duke qenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që institucionet politike bërës kanë:

- ✓ për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj të mire dhe pasurie publike të patjetërsueshme;
- ✓ në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm;
- ✓ duke mbajtur në konsideratë rrezikun që i kanoset nga ndotja mjedisit detar, ekuilibrit të tij ekologjik, burimeve dhe përdorimeve legjitime si dhe nga ndërtimet;
- ✓ si edhe në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se mungon një strategji e dedikuar për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare, me objektiva konkrete dhe tregues të matshëm. Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, i miratuar me vendim të KKT në vitin 2016, por i pa miratuar me VKM edhe pse ka pasur si qëllim hartimin dhe vënien në zbatim të një politike të integruar për zhvillimin e zonës bregdetare si një nga prioritetet qeverisëse në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit shqiptar të drejtuar nga procese planifikimi dhe konsultimi gjithëpërfshirës¹⁶ nuk rezulton të jetë i zbatueshëm, pasi mungon strategjia, objektivat dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij plani.

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit, nuk disponojnë të dhëna të sakta dhe të plota për të kryer analiza të thelluara kosto përfitim lidhur me përdorimin e hapësirave publike në plazhe, të cilat do të shërbenin për përcaktimin e objektivave të qëndrueshëm në strategjinë e dedikuar për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare.

Konkluzion 1: Mungesa e një strategjie për menaxhimin e integruar të bregdetit cenon drejtpërdrejt menaxhimin e qëndrueshëm të tij. Mungesa e të dhënave që përdoren për të kryer analiza kosto përfitim mund të çojë në vendim marrje të gabuara.

Rekomandim 1.1: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me bashkitë bregdetare, të ngrejë një grup pune për të kryer një analizë të plotë integrale të situatës në vijën bregdetare, e cila do të shërbejë hartimit të strategjisë kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit.

Brenda datë 30.06.2025

Rekomandim 1.2: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të marrë iniciativën për hartimin e një strategjie të dedikuar për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare dhe miratimin e saj.

Brenda datë 31.12.2025

2.Gjetje nga auditimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar një ligj specifik për menaxhimin e integruar të bregdetit, me qëllim dhënien e një statusi të veçantë juridik për zonën bregdetare, si një pronë publike e patjetërsueshme.

Shqipëria aderon në Konventën e Barcelonës “Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe”, ratifikuar në vitin 2000 me ligjin nr. 8690, datë 16.11.2000 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe”, si dhe 6 Protokollat shoqëruese”. Në vitin 2010 pranohet

¹⁶ https://planifikimi.gov.al/index.php?id=pins_bregdeti

një protokoll tjetër i Konventës së Barcelonës, miratuar me Ligjin nr. 10 234, datë 18.2.2010 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të Konventës së Barcelonës “Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Rajoneve Bregdetare të Mesdheut”. - Konventa e Barcelonës, i detyron palët që të sigurojnë përdorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare, në mënyrë që të ruajnë habitatin natyral të bregdetit, burimet natyrore dhe ekosistemet.¹⁷

Praktikat e mira që vijnë prej vendeve, si Greqia dhe Spanja, i japin vëmendje të veçantë mbrojtjes së bregdetit, duke e garantuar nëpërmjet një regjimi juridik të posaçëm. Greqia nëpërmjet ligjit për bregdetin dhe plazhin, ka vënë theksin e ndalimit të ndërtimeve pranë zonës së plazheve si dhe ka parashikuar rregullime sa i takon dhënies me qira. Ndërkaq Spanja e ka ngritur mbrojtjen e bregdetit dhe plazheve, si pronë publike në nivel kushtetues.¹⁸

Konkluzion 2: Miratimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të bregdetit do të garantonte zhvillim të qëndrueshëm të zonës bregdetare dhe të siguronte mbrojtjen dhe zhvillim të kontrolluar ndërtimesh, disiplinim të përdorimit të hapësirave publike në plazhe, në sinkron me politikat e qeverisë për zhvillimin e turizmit.

Rekomandim 2.1: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, bazuar në praktikat e mira, të hartojë Ligjin për Bregdetin, për krijimin e një sistemi të ri për menaxhimin e integruar të plazhit dhe bregdetit, ku të përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive të pushtetit vendor dhe institucioneve qendrore.

Brenda datë 31.12.2025

4.1.2.A janë procedurat e përcaktuara në funksion të përdorimit efektiv të hapësirave publike në plazhe?

Përdorimi efektiv i hapësirave publike në plazhe, kërkon përcaktimin dhe zbatimin e disa procedurave që synojnë sigurimin e aksesueshmërisë, funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së këtyre hapësirave.

Procedurat efektive për përdorimin e hapësirave publike në plazhe janë të domosdoshme për të siguruar një balancë midis aksesit të drejtë, ruajtjes së mjedisit dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm turistik.

Për sa i përket procedurave të ushtrimit të veprimtarisë në stacionet e plazhit që ka të bëjë me përgatitjen e hartës së përgjithshme për hapësirat publike të plazhit dhe hapësirave private të stacioneve të plazhit deri në aplikimin dhe miratimin e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171 datë 27.03.2019 “Për miratimin e Rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” (shfuqizuar), rezulton se janë ngarkuar disa institucione, e konkretisht: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; inspektorati përgjegjës për turizmin dhe inspektorati përgjegjës për shëndetin; Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST); Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA); Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore; Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Në fakt përgjegjëse kryesore për ushtrimin e veprimtarisë në stacionet e plazhit, duhet të jenë organet e qeverisjes vendore, referuar ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, këto organe kanë të drejtën të krijojnë struktura administrative për kryerjen e

¹⁷ https://planifikimi.gov.al/index.php?id=pins_bregdeti

¹⁸ Neni 132, pika 2 e Kushtetutës Spanjolle,

http://www.congreso.es/portal/page/portal/Congreso/Congreso/Hist_Normas/Norm/const_espa_texto_ingles_0.pdf

funksiioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi si dhe të zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë.

Ajo çka mund të përbëjë problem është fakti se procedura e verifikimit të ligjshmërisë zhvillohet pa penguar zbatimin e tyre dhe për të shmangur pasoja të padëshirueshme nga ky akt kërkohet bashkëpunim dhe mirëkuptim prej dy ose më shumë institucioneve. Ndërkohë që kjo praktikë shpesh ka ndikuar edhe në cilësinë e ofruar ndaj qytetarëve. Thua se njëloj problematike janë edhe rastet e përplasjeve që vijnë eventualisht nga mbivendosja e kontrolleve të ushtruara, siç janë ato nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Mjedsit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit apo inspektorët e Policisë Bashkiake, inspektorët e Drejtorive të Policisë së Shtetit dhe inspektorët e Drejtorive Rajonale të Tatimeve.

Për këtë është e nevojshme që praktikatat e kontrolleve të ushtruara nga administrata e pushtetit qendror tek ajo e pushtetit vendor të udhëhiqen vetëm nga dispozitat ligjore, në përputhje me parimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore i sanksionuar edhe në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Hartat planifikuese përkatëse, me qëllim përcaktimin e hapësirave publike dhe hapësirave private të stacioneve të plazhit, nuk kryhet sipas akteve rregullatorë.

Përgatitja sipas akteve rregullatorë të hartave planifikuese përkatëse, me qëllim përcaktimin e hapësirave publike të plazhit dhe hapësirave private të stacioneve të plazhit, ka mjaft rëndësi pasi është thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin efikas të këtyre zonave, të cilat janë burime të çmuara ekonomike, ekologjike dhe sociale.

Hartat planifikuese ndihmojnë në ndarjen dhe organizimin e hapësirave të plazhit për përdorime të ndryshme. Kjo ndarje ndihmon në shmangien e mbingarkesës dhe degradimit mjedisor. Një planifikim i qartë, i mbështetur në harta të detajuara, ndihmon autoritetet lokale në monitorimin dhe kontrollin edhe të ndërtimeve.

Harta e përgjithshme për hapësirat publike të plazhit dhe hapësirave private të stacioneve të plazhit, duhej të hartohet nga një grup pune i drejtuar nga njësi e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në përbërje të së cilës të kishte edhe përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare. Harta e përgjithshme pas hartimit duhet të miratohet, brenda muajit janar, me vendim të këshillit bashkiak, kërkesë kjo e nenit 4 të VKM-së nr. 171/2019, i ndryshuar (i shfuqizuar).

Kjo kërkesë nuk është zbatuar nga të gjitha njësitë e pushtetit vendor, por janë përdorur hartat e viteve të kaluara pa u azhurnuar me realitetin faktik të këtyre hapësirave, të cilat mund të kenë ndryshime si nga erozioni apo faktorë të tjerë.

Nga auditimi rezultoi se vetëm Bashkia Vlorë, nuk i ka të miratuara hartat e plazheve me vendim të këshillit bashkiak, siç kërkohet nga neni 4 pika 3 e VKM-së 171/2019, i ndryshuar (i shfuqizuar). Kjo le hapësirë që harta e përgjithshme të mos jetë e mirë studiuar dhe me analizën përkatëse për të gjithë tipologjinë e zonës bregdetare që administrohet nga Bashkia Vlorë.

Është e domosdoshme të parashikohet rregullimi ligjor dhe ndërhyrja në plazhet që funksionojnë si të tilla, edhe pse nuk janë pjesë e hartës së plazheve, përfshirë këtu dhe plazhet që gëzojnë statusin zonë e mbrojtur, apo plazheve të pa miratuara si “Porto Palermo”, plazhin e Gjipes, Krorëz, Karaburun, “Ishujt e Tetransit” etj.

3. Gjetje nga auditimi: Përgjegjësitë funksionale të AKB, konsistojnë ndër të tjera në ushtrimin e kontrollit dhe inspektimin në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që

ushtrojnë veprimtari turistike¹⁹, në hapësirat publike të plazhit dhe hapësirave private të stacioneve të plazhit, etj.

Nga ana tjetër, nga auditimi rezultoi se, në fakt janë Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit apo inspektorët e Policisë Bashkiake, inspektorët e Drejtorive të Policisë së Shtetit dhe inspektorët e Drejtorive Rajonale të Tatimeve, që kryejnë kontrole në subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike në hapësirat publike të plazhit dhe hapësirave private të stacioneve të plazhit. Kryerja e të njëjtit funksion nga dy ose më shumë institucioneve të ndryshme, sjell konfuzion pasi ekziston mundësia që një subjekti t'i shkohet për inspektim dy herë; për të njëjtën shkelje të penalizohet 2 herë; etj. Sa më sipër implikon gjithashtu kosto financiare shtesë, pasi për të njëjtin funksion mbështeten me buxhet dy herë, dy institucione të ndryshme.

Konkluzione 3: Përfshirja e shumë institucioneve në menaxhimin dhe veprimtarinë e stacioneve të plazhit, krijon një sistem të ngarkuar dhe të panevojshëm që ndikon negativisht në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe turistët.

Rekomandim 3.1: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në Ligjin për Bregdetin që do të rekomandojë për hartim, duhet të përcaktojë role dhe përgjegjësi të qarta të institucioneve të përfshira në menaxhimin e hapësirave publike në plazhe.

Brenda datë 31.12.2025

4. Gjetje nga auditimi: Përgatitja e hartës së përgjithshme për hapësirat publike të plazhit dhe hapësirave private të stacioneve të plazhit nga njësitë e vetëqeverisejs vendore, nuk është kryer çdo vit për ta përditësuar me realitetin faktik të këtyre hapësirave, të cilat mund të pësojnë ndryshime si nga erozioni apo faktorë të tjerë, siç kërkohet nga neni 4 pika 3 e VKM-së 171/2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar.

Konkluzione 4: Përgatitja dhe përditësimi i rregullt i hartave për hapësirat publike në plazhe çdo vit, krijon një bazë të dhënash të vlefshme për të marrë vendime të drejta, si dhe është thelbësore për menaxhimin efektiv dhe për garantimin e një përvoje të këndshme për vizitorët. Hartat ndihmojnë në organizimin, përdorimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e hapësirave të plazhit.

Rekomandim 4.1: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë, të marrin masa për azhurnimin çdo vit të hartave të plazheve dhe publikimin në faqen elektronike të tyre, para fillimit të sezonit turistik, duke rritur transparencën dhe në funksion të mirëadministrimit të pronës dhe pasurisë publike.

Brenda datë 30.06.2025


¹⁹ Vendim nr. 569, datë 17.7.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, Kapitulli III, pika 6

4.2 A janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme masat e marra për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe?

4.2.1. A përmbushin hapësirat publike në plazhe interesat e qytetarëve?

Raporti 30 % i hapësirës publike në plazh nuk është i trajtuar me përparësi.

Figura 8. Raporti hapësirës publike në plazhe.



Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik, për periudhën 2023-2024 bëhet proporcionalisht, sipas raportit 70%/30% dhe në mënyrë perpendikulare me vijën bregdetare. Hapësira e çdo plazhi (publik ose privat) kufizohet me vijën bregdetare.²⁰

Raporti 70% privat dhe 30% publik nuk garanton vërtetësi në terren, pasi ai nuk aplikohet për çdo zonë plazhi por në një territor të përgjithshëm. Për rrjedhojë hapësira e plazhit që duhet ti dedikohet publikut pa pagesë nuk është trajtuar me përparësi. Nga vëzhgimet në terren rezulton se hapësira që i rezervohet publikut, shpesh herë nuk është e përshtatshme dhe e aksesueshme për qytetarët. Vendndodhja e tyre shpesh herë është në afërsi të derdhjes së ujërave të zeza, në territor me papastërti, apo distancë nga zonat historike të plazheve. Në disa raste hapësira publike rezulton e zënë nga banorë të zonës me shezlong e çadra stacionare të mbyllura me zinxhir dhe dryna të cilat kanë shkaktuar cenim të së drejtës së shfrytëzimit të këtyre hapësirave nga pushuesit e tjerë rastësorë, si në rastin përgjatë vijës bregdetare Durrës dhe Kavajë.²¹

Nga një anë rezultojnë hapësira për publikun në masën 30%, në disa raste në zona aspak të përshtatshme, por nga ana tjetër gjatë periudhës që është audituar, ka rritje të sipërfaqes së kontraktuar nga subjekte private.

Të dhënat e mëposhtme tregojnë ecurinë e sipërfaqeve të kontraktuara nga hapësira publike në plazhe, për bashkitë subjekt auditimi.

²⁰ Vendim nr. 171, datë 27.3.2019, Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar (shfuqizuar), neni 4, pika 2.

²¹ Foto aneksi bashkëngjitur SHTOJCA

Tabela nr. 5 Sipërfaqet e kontraktuara gjatë periudhës 2022-2024

BASHKIA	2022	2023	2024	%
	Sipërfaqe e kontraktuar (m2)	Sipërfaqe e kontraktuar (m2)	Sipërfaqe e kontraktuar (m2)	Rritja 2024 kundrejt 2022
SHKODER	19,439	50,839	64,274	231%
LEZHE	20,969	62,311	74,106	253%
DURRES	90,945	107,809	131,681	45%
VLORE	46,345	73,527	119,654	158%
HIMARE	28,387	48,350	84,401	197%
SARANDE	33,136	39,956	80,622	143%
TOTAL	239,221	382,792	554,738	132%

Burimi AKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Sikundër vihet re sipërfaqja e kontraktuar nga subjekte privatë për të ushtruar veprimtarinë stacion plazhi, për periudhën 2022-2024 paraqet një tendencë rritje të lartë.

Nga krahasimi i sipërfaqes në vitin 2024 kundrejt vitit 2022 rezultojnë rritje të larta:

- në Bashkinë Lezhë nga 20.969 m2 në 74.106 m2 ose rritur në masën 253%
- në Bashkinë Shkodër nga 19.439 m2 në 64.274 m2 ose rritur në masën 231%
- në Bashkinë Himarë nga 28.387 m2 në 84.401 m2 ose rritur në masën 197%

duke vijuar me Bashkinë Vlorë ku rritja është në masën 158%, Bashkia Sarandë në masën 143% dhe Bashkia Durrës ka rritje në sipërfaqen e kontraktuar në masën më të ulët prej 45%. Në total për 6 bashkitë gjatë vitit 2022 është kontraktuar sipërfaqja prej 239.221 m2 e cila në vitin 2024 rritet në 554.738 m2 ose në përqindje në masën 132%.

Tabela nr. 6 Numri i shezlongëve të raportuar gjatë periudhës 2022-2024, ndarë sipas NJVQV-ve.

BASHKIA	2022	2023	2024	%
	Shezlong (nr)	Shezlong (nr)	Shezlong (nr)	Rritja 2024 kundrejt 2022
SHKODER	8082	7477	11093	37%
LEZHE	6224	13475	16146	159%
DURRES	20750	24298	26187	26%
VLORE	13466	17237	23580	75%
HIMARE	12480	9058	15020	20%
SARANDE	10612	9546	13319	26%
TOTAL	71,614	81,091	105,345	47%

Burimi AKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 7 Numri i subjekteve përfituese nga hapësira publike në plazhe për periudhën 2022-2024, ndarë sipas NJVQV-ve.

BASHKIA	2022	2023	2024	%
	Subjekte përfituese (nr.)	Subjekte përfituese (nr.)	Subjekte përfituese (nr.)	Rritja 2024 kundrejt 2022
SHKODER	70	67	70	0%
LEZHE	131	140	151	15%
DURRES	226	217	215	-5%
VLORE	186	204	209	12%
HIMARE	190	203	224	18%
SARANDE	142	141	154	8%
TOTAL	945	972	1023	8%

Burimi AKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Gjatë auditimit u konstatua gjithashtu edhe rritje e numrit të shezlongëve për çdo vit të periudhës 2022-2024, si dhe rritje e numrit të subjekteve përfitues nga hapësira publike në plazhe.

Në mënyrë të përmblodhur të dhënat e mëposhtme:


Tabela nr. 8 Ecuria e numrit të subjekteve përfitues, numrit të shezlongëve dhe sipërfaqeve të kontraktuara në total për bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë, Himarë, gjatë periudhës 2022-2024.

Emërtimi	viti 2022	viti 2023	viti 2024	Rritja 2024 kundrejt 2022 në %
Subjekte përfituese	945	972	1023	8%
Sipërfaqe e kontraktuar	239,221	382,792	554,738	132%
Shezlonge	71,614	81,091	105,345	47%

Burimi AKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në përfundim, në vitin 2024 kundrejt vitit 2022, në total për të gjitha bashkitë subjekt auditimi, rezulton tendencë në rritje e numrit të subjekteve përfitues, numrit të shezlongëve dhe sipërfaqeve të kontraktuara në total për bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë dhe Himarë.

Grafiku nr. 3 Paraqitja grafike e ecurisë së numrit të subjekteve përfitues, numrit të shezlongëve dhe sipërfaqeve të kontraktuara në total për bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë, Himarë, gjatë periudhës 2022-2024.



Burimi AKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Respektimi i standardeve në plazhet publike

Ofrimi i standardeve në plazhet publike, nga ana e njësive vendore, është një problematikë në vijim, referuar edhe raporteve të AKB për sezonin turistik 2022, 2023, 2024. Veçanërisht pjesa e kriterëve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastruktura e plazhit publik, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar.

Disa nga problematikat më të hasura, si më poshtë vijon:

- Tabelizimi i të gjitha hapësirave publike, ku të paraqitet termi “PLAZH PUBLIK” si dhe numrat e emergjencës dhe këshillat për pushuesit.
- Vendosja dukshëm dhe sinjalistika me shënimet: “Ky plazh nuk monitorohet me vajtues plazhi”, në rastet kur ky shërbim nuk ofrohet në këto plazhe.

- c) Ngritja e pikave të vrojtimit dhe pajisja e hapësirave publike me vrojtues të certifikuar.
- d) Sigurimi i pastrimit të paktën 2 herë në ditë të hapësirave publike.
- e) Pajisja e hapësirave publike me shërbime higjienike.
- f) Markimi i zonës së notimit.

Nga vrojtimet në terren të grupit të auditimit por edhe nga raportet e AKB, mund të veçohet zona e plazhit publik në Bashkinë Sarandë si një praktikë e mirë, ku përveçse është ruajtur memoria historike e qytetit është konstatuar se ishin të pajisura me pika vrojtimi dhe vrojtuesit të certifikuar, si dhe me të gjitha kushtet e nevojshme të sinjalistikës ujore dhe tabelat përkatëse (markimi i zonës së notimit).

Ndërkohë që një pjesë e mirë e plazheve publike vazhdojnë të shfaqin probleme të pazgjidhura ndër vite lidhur me respektimin e standardeve.

Gjatë sezonit turistik 2024, sipas raportit të AKB rezultojnë:

Në plazhet publike të zonës së Ksamilit është konstatuar mungesë e shërbimeve higjienike.

Në plazhet e Himarës, në plazhin Lukovë:

- Plazhet publike janë pa roje dhe pa sinjalistikën e nevojshme.
- Nuk ka plazhe të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara.

Në plazhin e Bunecit:

- Plazhet publike janë pa vrojtues dhe pa sinjalistikën e nevojshme.
- Nuk ka plazhe të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara.

Në plazhin e Borshit:

- Ka mungesë të investimeve në infrastrukturë nga ana e Bashkisë, rehabilitimi i rrugës, mungesa e ndriçimit, ujit, gjelbërimit, ka pasur kujdes të veçantë pastrimi i cili është bërë disa herë në ditë nga firma e pastrimit.
- Plazhet publike janë pa vrojtues dhe pa sinjalistikën e nevojshme.
- Në hapësirat publike nga ana e banorëve të zonës ngrihen çadra të pa çmontueshme me dru.
- Nuk ka plazhe të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara.

Në plazhin Qeparo dhe Porto Palermo:

- Në disa hapësira publike janë vendosur çadra të pa çmontueshme me drurë nga ana e banorëve të zonës.

Në plazhin e Porto Palermos plazhet janë shfrytëzuar nga publiku si plazhe publike edhe pse janë të pa miratuara.

- Nuk ka plazhe të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara.

Në plazhin Lllaman:

- Nuk ka plazhe të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara.

Në plazhin Potam, Maraç & Himarë, në plazhet publike mungojnë sinjalistika ujore si edhe vrojtuesit e licencuar;

Në plazhin e Livadhit, në plazhet publike mungojnë sinjalistika ujore, vrojtuesit e licencuar, si edhe kushtet e tjera si tualete, kabina zhveshje, dushe etj.

Nga kontrolli në plazhin e Dhërmiut, është konstatuar në plazhet publike mungojnë sinjalistika ujore si edhe vrojtuesit e licencuar.²²

Në Bashkinë Lezhë lidhur me plazhet publike, gjatë monitorimeve të ARB janë konstatuar se një pjesë e parcelave të paracaktuara si plazhe publike në zonat bregdetare nën juridiksionin territorial të kësaj të fundit për shkak të terrenit nuk janë lehtësisht të aksesueshme nga ana e publikut. Po ashtu zona bregdetare e Shëngjinit dhe ajo e Kunes kanë të paracaktuara si plazhe publike një numër shumë të vogël parcelash të cilat referuar fluksit të madh të turistëve si atyre ditorë, banorëve të Njësisë Administrative Shëngjin apo edhe atyre të cilët

²² Raport AKB, për sezonin turistik 2024

kanë investuar duke blerë shtëpi pushimi në këto zona bregdetare, këto të fundit e kanë të pamundur përballimin e këtij fluksi.²³

Sipas raportit të AKB për vitin 2024 Nga aksionet e realizuara prej ARB Vlorë, janë liruar një numër i konsiderueshëm plazhesh, përfshirë edhe në Parkun e Mbrojtur Detar Karaburun-Sazan. ARB Vlorë i është drejtuar zyrtarisht Policisë Bashkiake (për bashkitë respektive) me qëllim mbajtjen në monitorim të parcelave të liruara.

Sipas vëzhgimeve të grupit të auditimit në plazhet publike të bashkisë Vlorë, konkretisht në zonën e Lungomares dhe Pashalimanit, rezultuan jashtë çdo standardi që parashikon Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar (shfuqizuar).

Problematikë tjetër e shfaqur në gjithë periudhën e auditimit është nevoja për një numër më të lartë vrojtuesish plazhi, të cilët duhet të angazhohen në këtë lloj shërbimi në plazhe. Shumë subjekte kanë paraqitur në AKB shqetësimin se nuk arrijnë të gjejnë vrojtues plazhi të certifikuar në tregun e punës, pikë për të cilën AKB sugjeron promovimin e trajnimeve që po ofrohen dhe nga Universiteti i Sporteve në bashkëpunim me Qendrën e Urgjencës Kombëtare.²⁴

Ndërsa puna e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, bazuar dhe në Urdhrin e Kryeministrit nr. 69, datë 30.04.2024 “Për ngritjen e Task – Forcës ndërinstitucionale të Sezonit Turistik veror 2024”, është përqendruar në:

Monitorimi i parcelave të përcaktuara si plazhe publike, kriterëve dhe standardeve në këto plazhe, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar,²⁵(shfuqizuar).

Gjatë auditimit u evidentua se nuk rezulton asnjë masë e marrë për mungesën e standardeve²⁶ në plazhet publike të bashkive subjekt i këtij auditimi nga ana e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Foto 1. Plazhi publik Golem



²³ Raport AKB, për sezonin turistik 2024

²⁴ Raporti AKB për sezonin turistik 2024, Problematika të sezonit turistik.

²⁵ Raport AKB, për sezonin turistik 2024

²⁶ Vendimi nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar

Foto 2. Pamje nga plazhi publik Pashaliman



Plazhet publike në bashkitë subjekt auditimi, duke përjashtuar Bashkinë Sarandë, nuk përmbushin plotësisht standardet si nga pikëpamja e infrastrukturës ashtu edhe kushtet e sigurisë.²⁷

Strukturat e dedikuara për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe.

Procedura e ndjekur nga bashkitë, subjekt auditimi për lidhjen e kontratave të plazhit, kërkon përfshirjen e disa strukturave brenda institucionit nga momenti i njoftimit të listës paraprake të përfituesve nga ana e AKB deri në finalizimin nëpërmjet proces verbalit të dorëzimit të parcelave subjekteve përfituese.

Nga auditimi rezultoi se procedurat e ndjekura nëpërmjet një evidence të dokumentuar në mënyrë korrekte u konstatuan vetëm në Bashkitë Lezhë dhe Shkodër.

Bashkitë Himarë, Sarandë, Vlorë dhe Durrës, e kryenin nëpërmjet një procesi kaotik dhe pjesërisht të dokumentuar.

Menaxhimi i hapësirës publike në plazhe është një proces që duhet administruar gjatë gjithë vitit.

Nga evidenca e paraqitur rezultoi se ky proces kryhej nëpërmjet ngritjes së një grupi me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, i cili do të menaxhonte sezonin turistik vetëm gjatë periudhës në cilin shtrihet sezoni dhe jo gjatë gjithë vitit.

5. Gjetje nga auditimi: Hapësirat e dedikuara si plazhe publike edhe pse kanë rezultuar në përmbushje të raportit 30% kundrejt hartës së plazheve të miratuar, nuk janë të trajtuar me përparësi. Raporti 30% publik nuk garanton vërtetësi në terren, pasi ai nuk aplikohet për çdo zonë plazhi por në një territor të përgjithshëm. Nga vëzhgimet në terren rezulton se hapësira që i rezervohet publikut, shpesh herë nuk është e përshtatshme dhe e aksesueshme për qytetarët. Vendndodhja e tyre shpesh herë është në afërsi të derdhjes së ujërave të zeza, në territor me papastërti, apo në distancë nga zonat historike tradicionale të plazheve.

Ofrimi i standardeve në plazhet publike, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, mbetet një problematikë në vijim. Plazhet publike nuk janë të pajisura me pika vrojtimi dhe vrojtuesit të certifikuar, si dhe me të gjitha kushtet e nevojshme të sinjalistikës ujore dhe tabelat përkatëse (markimi i zonës së notimit). Mungojnë shërbimet higjienike si edhe plazhe të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara.

²⁷ Vendimi nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar

Konkluzion 5: Mungesa e trajtimit me përparësi të plazheve publikë, mungesa e respektimit të standardeve të përcaktuara nuk përmbush pritshmërinë e qytetarëve dhe cenon imazhin e vendit si destinacion turistik.

Rekomandim 5.1: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të rishikojnë kuadrin ligjor dhe rregullator, me synim përfshirjen në procesin e inspektimit edhe NJVQV-të bregdetare, për të garantuar të drejtën e qytetarëve për akses në plazhe, kundrejt standardeve që duhet të plotësojnë dhe për të shmangur problematikat e mësipërme.

Brenda datë 30.06.2025

6. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha bashkitë që janë subjekt i këtij auditimi, nuk ka struktura të veçanta, të dedikuara, të cilat të kenë përgjegjësi funksionale menaxhimit të plazheve si në sezonin zyrtar të plazhit ashtu edhe në periudhë përgatitore apo pas përfundimit të këtij sezoni, gjë që do ta rriste përgjegjësinë e administratës së njësive të vetëqeverisjes vendore, në rritjen e nivelit të shërbimeve në këto zona si dhe të studimit të nevojave apo analizave ekonomike.

Konkluzion 6: Mungesa e strukturave të dedikuara për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe, krijon mundësi për keq menaxhim të aseteve publike.

Rekomandim 6.1: Bashkitë Sarandë, Himarë, Vlorë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër të ngrenë struktura të veçanta për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe si dhe të planifikojnë një zë të veçantë në buxhetin vjetor të shpenzimeve, ku të parashikohen ndërhyrjet e domosdoshme edhe në infrastrukturën e plazheve (si furnizimi me ujë, energji etj.).

Brenda datë 30.06.2025

4.2.2. Si ka evoluar ecuria e të ardhurave të vjela nga dhënia në përdorim e hapësirave publike në plazhe?

Tarifa për zënien e hapësirës publike në plazhe nuk është rishikuar.

Bazuar në kuadrin ekzistues ligjor Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë.²⁸

Njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin tarifa për zënien e hapësirës publike²⁹

Tarifat për m² të miratuara me Vendim të Këshillave Bashkiake, të 6 bashkive të përzgjedhura si subjekt auditimi, ndryshojnë nga një bashki në tjetrën, duke variuar nga 200-800 lekë/m² për sezon turistik. Disa nga bashkitë, konkretisht Bashkia Durrës, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë e vendosin tarifën për zënien e hapësirës publike në plazhe bazuar në disa element që i përkasin territorit, llojit të plazhit, etj., ndërsa në bashkitë Himarë, Sarandë tarifa është e njëjtë pavarësisht territorit ku ndodhet plazhi. Nga intervistat që grupi i auditimit ka kryer me strukturat përgjegjëse të bashkive është konstatuar se niveli i të ardhurave që përfitohet nga vjela e tarifës së zënies së hapësirës në plazhe nuk mbulon shpenzimet që kryhen për pastrimin, monitorimin, plotësimin e standardeve që duhet të kenë plazhet publik, etj.

Disa nga bashkitë kanë kryer rishikim të tarifës për zënien e hapësirës publike ose rishikim të ndarjes së zonave të plazhit.

²⁸ Ligj Nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Neni 14

²⁹ Ligj Nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Neni 15, pika 1

Konkretisht, Bashkia Lezhë ka kryer një rishikim të zonave të plazheve në Vendimin e KB nr. 64 datë 31.10.2023, duke kryer ndryshimin e ndarjes së territorit të plazhit(zoonimin) në kuadër të ndarjes administrative territoriale për efekt të diferencimit në ofrimin e cilësisë së shërbimeve ndaj kategorisë së taksapaguesve me qëllim bashkërendimin dhe përafrimin e koston e tyre me nivelin e aplikimit të tarifave vendore³⁰, pa kryer ndryshim në masën e tarifës.

Bashkia Vlorë ka kryer rishikim të zonës së plazheve dhe tarifave përkatëse në Vendimin e KB nr. 96 datë 07.12.2023 duke kryer një kategorizim edhe të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në zonën e plazhit.

Për zënien e hapësirave publike në plazhin e Nartës dhe Plazhin e Vjetër

- Për njësitë akomoduese (hotel, motel, bujtina, etj. 400 lekë/m2/ sezon
- Për subjektet për stacion plazhi, bare, restorante 500 lekë/m2/ sezon

Për zënien e hapësirave publike në plazhin e Lungomare I (Fillimi i Lungomares deri te fushat e sportit)

- Për njësitë akomoduese (hotel, motel, bujtina, etj., 600 lekë/m2/ sezon
- Për subjektet për stacion plazhi, bare, restorante 700 lekë/m2/ sezon

Për zënien e hapësirave publike në plazhin nga fushat e sportit- Pashaliman, Orikum

- Për njësitë akomoduese (hotel, motel, bujtina, etj 650 lekë/m2/ sezon
- Për subjektet për stacion plazhi, bare, restorante 750 lekë/m2/ sezon³¹

Tarifat për zënien e hapësirës publike në plazhe si edhe ecuria e tyre gjatë periudhës 2022-2024, në bashkitë objekt auditimi paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr. 9 Tarifat për zënien e hapësirës publike në plazhe për periudhën 2022-2024

Tarifa leke/m2/sezon turistik				
Nr.	NJVQV	2022	2023	2024
1	Bashkia Sarandë	800	800	800
2	Bashkia Himarë	750	750	750
3	Bashkia Durrës (Rrashbull, Ishëm, Hamallaj)	500	500	500
	Bashkia Durrës (Katund i ri, Sukth)	200	200	200
4	Bashkia Vlorë (Narta, Plazhi vjetër)	400	400	400/500
	Bashkia Vlorë (gjithë plazhet e tjerë, veç pikës 1)	500	500	600/700
	Bashkia Vlorë (nga fusha e sportit- Pashaliman)			650/750
5	Bashkia Lezhë Zona 1	600	600	600
	Bashkia Lezhë Zona 2	500	500	400
	Bashkia Lezhë Zona 3	450	450	0
	Bashkia Lezhë Zona 4	400	400	0
6	Bashkia Shkodër Velipojë - Zona A/V	490	490	490
	Bashkia Shkodër Velipojë - Zona A/B	490	490	490
	Bashkia Shkodër Velipojë - Zona B/V	350	350	350
	Bashkia Shkodër Velipojë - Zona B/B	350	350	350
	Bashkia Shkodër Velipojë - Zona A/Rr	350	350	350


Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Sikundër mund të shihet nga të dhënat e mësipërme tarifën më të lartë për zënien e hapësirës publike në plazhe e ka Bashkia Sarandë 800 lekë/m2/sezon turistik, pasuar nga Bashkia Himarë me 750 lekë/m2/sezon turistik, të cilat e kanë të unifikuar pa diferencim territorial.

³⁰ Bashkia Lezhë Vendim i KB nr. 64 datë 31.10.2023

³¹ Bashkia Vlorë Vendim i KB nr. 96 datë 07.12.2023

Grafiku nr. 4 Paraqitja grafike e tarifave(maksimale) të bashkive për vitin 2024



Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Rritja e sipërfaqeve të kontraktuara nuk është shoqëruar me rritjen e të ardhurave që vilen nga tarifa për zënien e hapësirës publike në plazhe.

Nga auditimi rezultoi rritje e sipërfaqes së kontraktuar në të gjitha bashkitë objekt auditimi për gjatë periudhës 2022-2024.

Konkretisht:

- Në Bashkinë Shkodër, sipërfaqja e kontraktuar në vitin 2022 ka qenë 19.439 m² kundrejt 64.274 m² në vitin 2024 , duke evidentuar një rritje në masën 231% ;
- Në Bashkinë Lezhë, sipërfaqja e kontraktuar në vitin 2022 ka qenë 20.969 m² kundrejt 74.106 m² në vitin 2024 , duke evidentuar një rritje në masën 253% ;
- Në Bashkinë Durrës, sipërfaqja e kontraktuar në vitin 2022 ka qenë 90.945 m² kundrejt 131.681 m² në vitin 2024 , duke evidentuar një rritje në masën 45% ;
- Në Bashkinë Vlorë, sipërfaqja e kontraktuar në vitin 2022 ka qenë 46.345 m² kundrejt 119.654 m² në vitin 2024 , duke evidentuar një rritje në masën 158% ;
- Në Bashkinë Himarë, sipërfaqja e kontraktuar në vitin 2022 ka qenë 28.387 m² kundrejt 84.401 m² në vitin 2024 , duke evidentuar një rritje në masën 197% ;
- Në Bashkinë Sarandë, sipërfaqja e kontraktuar në vitin 2022 ka qenë 33.136 m² kundrejt 80.622 m² në vitin 2024 , duke evidentuar një rritje në masën 143% ;³²

Të dhënat nga bashkitë subjekt auditimi mbi të ardhurat e realizuara për periudhën 2022-2024, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 10 Të ardhurat e përfitësuara nga vjelja e tarifës për zënien e hapësirës publike në plazhe. Periudha 2022-2024.

Nr		2022	2023	2024	Rritja % v.2024/v.2022	Totali
1	Bashkia Shkodër	35,440,000	40,353,000	45,453,590	28	121,246,590
2	Bashkia Lezhe	53,732,523	51,903,097	65,186,060	21	170,821,680
3	Bashkia Durrës	113,201,214	106,300,645	120,701,237	7	340,203,096
4	Bashkia Vlore	38,537,270	43,759,360	59,051,310	53	141,347,940
5	Bashkia Himare	88,887,000	112,114,360	117,618,150	32	318,619,510
6	Bashkia Sarande	57,524,000	55,328,800	77,430,400	35	190,283,200
	Totali	387,322,007	409,759,262	485,440,747	25	1,282,522,016

Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

³² Të dhenat nga AKB sipas Tabelës nr.5 fq. 28

Nga të dhënat e raportuara nga bashkitë subjekt i auditimit rezulton:

Bashkia Himarë, Shkodër dhe Vlorë paraqesin një ecuri në rritje të ardhurave për periudhën objekt auditimi.


Bashkia Lezhë, Durrës, Sarandë paraqesin një rënie e të ardhurave gjatë vitit 2023.

Viti 2024 për të gjitha bashkitë paraqet rritje në raport me periudhën paraardhëse.

Të ardhura më të larta për periudhën 2022-2024 janë realizuar nga Bashkia Durrës në vlerën 340.203.096 lekë, pasuar nga Bashkia Himarë në vlerën 318.619.510 lekë.

Të ardhurat më të ulta për periudhën 2022-2024 janë realizuar nga Bashkia Shkodër në vlerën 121.246.590 lekë, pasuar nga Bashkia Vlorë në vlerën 141.347.940 lekë.

Grafiku nr. 5 Pesha specifike% e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës 2022-2024 nga bashkitë, kundrejt totalit.



Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në totalin e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës 2022-2024 rezulton:

27% e totalit është realizuar nga Bashkia Durrës

25% e totalit është realizuar nga Bashkia Himarë

15% e totalit është realizuar nga Bashkia Sarandë


13% e totalit është realizuar nga Bashkia Lezhë

11% e totalit është realizuar nga Bashkia Vlorë

9% e totalit është realizuar nga Bashkia Shkodër

Të ardhurat e realizuara nga vjelja e tarifës së zënies së hapësirës publike në plazhe është e ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shtrirja territoriale e plazheve dhe përcaktimi i tarifës, nga bashkitë.

Grafiku nr. 6 Paraqitja grafike e ecurisë së të ardhurave të realizuara gjatë periudhës 2022-2024.



Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në përfundim:

- Rritje e sipërfaqes së kontraktuar nga subjektet privatë nga 239.221 m² në vitin 2022 në 554.738 m² në vitin 2024 ose rritje në masën 132%.
- Rritja e të ardhurave të vjela nga bashkitë në total nga 387,322,007 lekë në vitin 2022 në 485,440,747 lekë në vitin 2024 ose rritje në masën 25%.

Subjekte Debitorë për pagesën e tarifës së zënies së hapësirës publike në plazhe.

Nga auditimi rezultoi se pothuajse në të gjitha bashkitë rezultojnë debitorë për pagesën e tarifës së zënies së hapësirës publike në plazhe.

Tabela nr. 11 Debitorë për pagesën e tarifës së zënies së hapësirës publike në plazhe.

Nr.	Bashkia	2022	2023	2024	Totali
1	Sarandë		588,000	1,828,000	2,416,000
2	Himarë		1,122,000		1,122,000
3	Vlorë				-
4	Durrës		851,705	2,365,000	3,216,705
5	Lezhë		309,000		309,000
6	Shkodër		392,000	754,882	1,146,882

Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Shënim: Bashkia Vlorë nuk i është përgjigjur pyetësorit të fazës së terrenit me gjithë insistimin e grupit të auditimit, për këtë arsye nuk janë raportuar të dhënat e debitorëve(nëse ka) për këtë subjekt.

Një nga arsyet kryesore të ekzistencës së debitorëve është fakti se për subjektet përfituese të hapësirave publike në plazhe të cilët kanë lidhur kontrata më të gjata se një vit, pas marrjes së kontratës nuk ju lind detyrim të paraqiten në Bashki për të kryer veprime të tjera në vitet pasardhëse, si p.sh marrja e plan vendosjes së sipërfaqes etj., duke mos kryer pagesat për çdo vit ushtrimor.

Ky fakt është i njohur edhe nga AKB e cila në raportet e saj citon: “Nga ana e njësive vendore, nevojitet gjithashtu një angazhim për mbledhjen e të ardhurave nga ana e subjekteve

që disponojnë një kontratë ekzistuese për përdorimin e hapësirës së plazhit (me afat 5 vjeçar, nënshkruar nga sezoni turistik veror 2021).”³³

Fondet e dedikuara për menaxhimin e hapësirës publike në plazhe.

Gjatë auditimit, u kërkuar nga subjektet të dhëna lidhur me fonde të dedikuara për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe.

Të dhënat e raportuara nga bashkitë si më poshtë vijon:

Tabela nr. 12 Fonde të dedikuara për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe

Nr.	Bashkia		2022	2023	2024
1	Sarandë	Mirëmbajtje plazhe publike	500,000	1,200,000	1,200,000
2	Himarë		-	-	-
3	Vlorë		-	-	-
4	Durrës		-	-	-
5	Lezhë		-	-	-
6	Shkodër	Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në plazhe			1,500,000

Burimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Ecuria e të ardhurave nga subjektet përfituese të hapësirave publike në plazhe.

Gjatë auditimit, grupi i auditimit nëpërmjet një kërkesë për bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve mori disa informacione lidhur me subjektet tatimpaguese, të cilat janë përfituese të hapësirave publike në plazhe për të analizuar disa elementë që do ti shërbenin auditimit.

Referuar të dhënave të marra nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit për subjektet e pajisura me kontrata për përdorimin e hapësirës së plazhit për sezonin turistik 2022, 2023 dhe 2024, janë raportuar nga DPT të dhëna si më poshtë:

Numri i subjekteve tatimpaguese për vitin 2022 ka qenë 696.

Numri i subjekteve tatimpaguese për vitin 2023 ka qenë 799.

Numri i subjekteve tatimpaguese për vitin 2024 ka qenë 817.

Lloji i aktivitetit të subjekteve tatimpaguese sipas të dhënave të administratës tatimore (Të dhënat e plota tabelat në aneksin bashkëngjitur, Shtojca)³⁴

Tabela nr. 13 Lloji i veprimtarisë së subjekteve tatimpaguese që shfrytëzojnë hapësirat publike në plazhe. Periudha 2022-2024

Nr.	Kodi rev. 2	2022	2023	2024	Totali periudhës
1	Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive	36	34	31	101
2	Akomodime të tjera	26	34	38	98
3	Aktivitete të shërbimit të pijeve	179	181	180	540
4	Hotele dhe struktura të ngjashme	178	221	211	610
5	Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	123	156	165	444
6	Aktivitetet e shërbimeve ushqimore të tjera	19	14	19	52
7	Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulotë argëtimi	18	24	27	69
8	Aktivitete të tjera argëtimi dhe çlodhëse p.k.t.	15	20	21	56
9	Aktivitete të operatorëve turistikë	6	4	8	18
10	Aktivitete të tjera të ndryshme nga fusha e turizmit	96	111	117	324
	Totali	696	799	817	2312


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

³³ Raporti AKB për sezonin turistik 2024, Problematika të sezonit turistik.

³⁴ Email DPT Monday, September 30, 2024 10:15 AM

Sikundër mund të shihet numri i subjekteve përfituese të hapësirave publike në plazhe ka ardhur në rritje për periudhën 2022-2024.

Grafiku nr. 7 Pesha specifike që zënë sipas fushës së aktivitetit të subjekteve përfituese të HPP kundrejt totalit të përfituesve të hapësirave publike në plazhe.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Ndërkohë pesha specifike sipas llojit të veprimtarisë së subjekteve tatimpaguese të cilat janë përfituese të hapësirave publike në plazhe, është si më poshtë vijon:

- 27% në fushën: Hotele dhe struktura të ngjashme
- 23 % në fushën: Aktivitete të shërbimit të pijeve
- 19% në fushën: Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm
- 14% në fushën: Aktivitete të tjera të ndryshme nga fusha e turizmit

Për këta tatimpagues janë kërkuar nga drejtoria TIK në DPT artikujt për faturat e lëshuara gjatë periudhës Qershor - Gusht 2022, Qershor - Gusht 2023 dhe Qershor - Gusht 2024 nga sistemi i fiskalizimit. Periudha është 3 mujore pasi të dhënat janë të mëdha dhe kërkojnë një kohë shumë të madhe procesimi.³⁵

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për gjenerimin e të dhënave që ju vunë në dispozicion auditimit, u krye kërkimi për artikull nëpërmjet fjalëve kyçe: cader, çader, cadër, çadër, shezllone, shazllone, shezlon, cadra, çadra, gazebo, umbrella, të gjitha këto emërtime të përdorura nga subjektet tatimpaguese. Nga administrata tatimore konfirmohet se mundet të ketë edhe fjalë të tjera të përdorura nga ana e tatimpaguesve për artikullin çadër/shezllone. Të dhënat për subjektet përfituese nga hapësirat publike në plazhe si më poshtë:

Tabela nr. 14 Të dhëna mbi xhiron nga sistemi i fiskalizimit për periudhën 2022-2024(Qershor- Gusht)

	Vlera totale pa TVSH Qershor - Gusht për artikujt e kërkuar (cader, shezllone...)	Vlera totale me TVSH Qershor - Gusht për artikujt e kërkuar (cader, shezllone...)
Viti 2022	406,270,098	447,160,060
Viti 2023	535,536,524	595,600,730
Viti 2024	594,594,447	657,918,741
Totali për periudhën 2022-2024	1,536,401,069	1,700,679,531

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

³⁵Email DPT Monday, September 30, 2024 10:15 AM

Siç vihet re nga të dhënat e raportuara mbi xhiron e subjekteve për periudhën qershor-gusht rezulton një rritje e xhiros së subjekteve tatimpaguese.
Në vitin 2023 kundrejt vitit 2022 është një rritje në masën 24%.
Në vitin 2024 kundrejt vitit 2023, rritja në masën 10%.

Tabela nr. 15 Të dhëna mbi numrin e subjekteve përfituese nga hapësira publike në plazhe, nga sistemi i fiskalizimit për vitin 2024.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Numër subjektesh nga AKB pavarësisht statusit, pasi gjate periudhës mund të mos kenë qene aktive disa subjekte	nr.	817
2	Numri i tatimpaguesve të cilët kanë lëshuar të paktën një faturë që ka në përshkrimin e artikullit çadër/shezllone Qershor - Gusht 2024	nr.	569
3	Numri i subjekteve përfituese nga hapësira publike në plazhe, por jo aktive	nr.	22
4	Numri i faturave që ka në përshkrimin e artikullit çadër/shezllone Qershor - Gusht 2024	nr.	402120
5	Sasia e çadrave Qershor - Gusht 2024	cope	699272
6	Vlera totale pa TVSH(Ne vlerë totale nuk janë llogaritur artikuj që kanë çadër+akomodim+shtesa të tjera)	leke	594594447
7	Vlera totale me TVSH(Ne vlerë totale nuk janë llogaritur artikuj që kanë çadër+akomodim+shtesa të tjera)	leke	657918741

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Për sa më sipër nga përlllogaritjet e përafërta dhe orientuese të të dhënave të tabelës së mësipërme konstatohet se subjektet e kontraktuara nga AKB mesatarisht 5.5 fatura tatimore të fiskalizuara në ditë.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në kuadër të bashkëpunimit për këtë auditim rezulton:

Numri i subjekteve përfituese nga hapësira publike në plazhe që i dërgohet DPT nga AKB për vitin 2024 është 817 subjekte, nga të cilët:

22 subjekte nuk kanë qenë aktive (shih të plotë tabelën nr.4 Shtojca)

569 subjekte që kanë lëshuar të paktën një faturë që ka përshkrimin çadër/ shezllonë.

226 subjekte që nuk kanë faturuar me emërtimin çadër/ shezllonë

Për periudhën qershor-gusht 2024 rezulton:

Sasia e çadrave 699.272

Numri i faturave që kanë përshkrimin çadër /shezllonë 402.120.


Nga një analizë që ju bë aktivitetit të subjekteve që përfitojnë nga hapësirat publike në plazhe dhe faturimit të artikujve çadra shezllonë, rezulton:

Tabela nr. 16 Aktiviteti i subjekteve që faturonjë artikujt çadër/shezllonë

Aktiviteti i subjektit përfitues nga sistemi i fiskalizimit	Numri i faturave
Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	129,691
Hotele dhe struktura të ngjashme	111,944
Aktivitete të shërbimit të pijeve	78,937
Aktivitete të tjera	81,548
Totali	402,120

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Grafiku nr. 8 Paraqitja grafike e peshës specifike në totalin e faturimit sipas aktivitetit të subjekteve nga sistemi i fiskalizimit.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga grafiku shihet se subjektet që përfitojnë nga hapësirat publike në plazhe dhe kanë faturuar çadra/shezllonë gjatë periudhës qershor-gusht 2024, kanë peshë specifike në totalin e faturave të lëshuara, bazuar në llojin e aktivitetit që ushtrojnë, si më poshtë:

32% Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm;

28% Hotele dhe struktura të ngjashme;

20% Aktivitete të shërbimit të pijeve

20% Aktivitete të tjera

Koordinimi mes institucioneve

Nga raportet e AKB për periudhën objekt auditimi 2022-2024, rezultojnë të dhëna mbi të ardhurat e vjela nga bashkitë bregdetare nga tarifa e zënies së hapësirës publike.

Nga ana e NJVQV-ve subjekt i këtij auditimi janë raportuar të dhëna mbi të ardhurat e vjela si më poshtë vijon:

Tabela nr. 17 Të dhëna mbi të ardhurat e realizuara nga AKB dhe bashkitë për periudhën 2022-2024.

Nr.	Bashkia						
		2022 sipas raportit AKB	2022 sipas raportimit nga subjektet	2023 sipas raportit AKB	2023 sipas raportimit nga subjektet	2024 sipas raportit AKB	2024 sipas raportimit nga subjektet
1	Lezhë	54,202,610	53,732,523	54,018,173	51,903,097	64,098,860	65,186,060
2	Shkodër	38,266,950	35,440,000	42,841,890	40,353,000	44,100,000	45,453,590
3	Durrës	113,652,540	113,201,214	100,084,195	106,300,645	115,987,737	120,701,237
4	Vlorë	39,000,000	38,537,270	39,000,000	43,759,360	55,180,210	59,051,310
5	Himarë	107,000,000	88,887,000	103,019,210	112,114,360	115,035,150	117,618,150
6	Sarandë	64,268,500	57,524,000	50,369,400	55,328,800	82,396,100	77,430,400
	Total	416,390,600	387,322,007	389,332,868	409,759,262	476,798,057	485,440,747
	Diferenca(vlere)		-29,068,593		20,426,394		8,642,690

Burimi: AKB, Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Analizat e munguara kosto përfitim për dhënien në përdorim të hapësirave publike në plazhe.

Në përgjigje të pyetjes a janë kryer analiza të thelluara kosto përfitim lidhur me dhënien në përdorim të hapësirave publike në plazhe, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, citon si më poshtë vijon:

“Nga mirë menaxhimi i hapësirës së plazheve të miratuara është konstatuar një rritje e konsiderueshme e të ardhurave nga qiradhënia.

Kostot në lidhje me procesin e dhënies me qira janë kosto administrative dhe kosto të inxhinierëve specialistë të cilat janë të papërfillshme në lidhje me të ardhurat e realizuara.”³⁶

Bashkia Shkodër është e vetmja njësi e cila është duke punuar një projekt studim, shoqëruar edhe me efektet financiare për menaxhimin e sipërfaqes së plazhit. Sipas këtij projekti të ardhurat që sigurohen nga ri konceptimi i menaxhimit të hapësirës publike në plazh, rriten në mënyrë të ndjeshme duke projektuar vlera disa herë më të larta se të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2024. Analiza e kryer merr në konsideratë gjatësinë e vijës bregdetare, sipërfaqen e përgjithshme të plazhit, kapacitetin e pushuesve, parametrat mjedisorë, infrastrukturën, klimën, faktorë të tjerë atmosferikë, etj., duke përdorur të dhëna analitike krahasuese.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet në vitin 2024 kundrejt vitit 2022, në total për të gjitha bashkitë subjekt auditimi, rezulton:

- Rritje e sipërfaqes së kontraktuar nga subjektet privatë nga 239.221 m² në vitin 2022 në 554.738 m² në vitin 2024 ose rritje në masën 132%.
- Rritje e numrit të shezlongëve, të vendosur nga subjektet privatë, nga 71.614 në vitin 2022 në 105.345 në vitin 2024 ose rritje në masën 47%.
- Rritje e numrit të subjekteve private përfituese nga hapësira publike në plazhe nga 945 në vitin 2022 në 1023 në vitin 2024 ose rritje në masën 8%.

Gjithashtu evidentohet një tendencë në rritje e nivelit të të ardhurave të realizuara në total nga bashkitë nga vjelja e tarifës së zënies së hapësirës publike në plazhe, për periudhën 2022-2024.

Pavarësisht ecurisë dhe tendencës në rritje të të ardhurave në secilën bashki, ato nuk kanë qenë në proporcion të drejtë me rritjen e sipërfaqes së kontraktuar për periudhën 2022-2024.

Ndërsa sipërfaqet e kontraktuara në bashkitë bregdetare pasqyrojnë rritje në masën nga 45%-253%, të ardhurat nga vjelja e tarifës që aplikohet për sipërfaqet e kontraktuara kanë një rritje në masën nga 7%-37%.

8. Gjetje nga auditimi: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Himarë, Sarandë gjatë periudhës 2022-2024, nuk kanë kryer asnjë studim apo analizë kosto përfitim lidhur me menaxhimin e hapësirave publike në plazhe, përfshirë edhe rishikimin e vlerës së tarifës për zënie të tyre.

Tarifa ka mbetur e njëjtë për periudhën dhe mund të konsiderohet si proces formal mbajtja në të njëjtat nivele e saj nga një vit në tjetrin.

Bashkitë Sarandë, Himarë, Vlorë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër nuk kanë plane veprimi dhe zhvillimi afatmesëm për plazhet, të miratuara në Këshillin Bashkiak.

Konkluzion 7: Mungesa e analizave kosto përfitim dhe studimeve të dinamikave në fushën e turizmit, duke krijuar mundësi për një proces formal të miratimit të tarifave, mund të cenojë efektivitetin dhe rritjen e të ardhurave nga ana e NJVQV.

³⁶ Përgjigje MTM pyetësori i fazës së terrenit

Konkluzion 8: Mungesa e planeve të veprimit dhe zhvillimit afatmesëm për plazhet cenon drejtpërdrejtë mekanizmin e menaxhimit të hapësirave publike në plazhe dhe mund të çojë në vendim marrje të gabuara.

Rekomandim 8.1: Bashkitë Sarandë, Himarë, Vlorë, Durrës dhe Lezhë të marrin masa për të kryer analizë kosto përfitim lidhur me menaxhimin e hapësirave publike, përfshirë edhe rishikimin e tarifave për zënien e hapësirës publike në plazhe dhe pas kryerjes së tyre të hartojnë dhe miratojnë në Këshillin Bashkiak, plane veprimi dhe zhvillimi afatmesëm për plazhet.

Brenda datë 31.12.2025

9. Gjetje nga auditimi: Në bashkitë, subjekt auditimi rezultojnë debitorë në pagesat e tarifës për zënien e hapësirës publike në plazhe për periudhën 2023-2024. Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk disponon të dhëna të sakta lidhur me numrin e subjekteve debitorë, emrat dhe vlerat përkatëse.

Konkluzion 9: Ekzistenca e debitorëve për zënien e hapësirës publike në plazhe është tregues i një menaxhimi jo efektiv i të ardhurave nga ana e bashkive dhe mungesë bashkëpunimi mes tyre dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Rekomandim 9.1: Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, të marrin të gjitha masat për arkëtimin e detyrimeve të lindura nga mos shlyerja dhe mos përmbushja e detyrimeve kontraktore të stacioneve të plazhit të dhëna me qira subjekteve private.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandim 9.2: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për krijimin e një *data base* të subjekteve të cilët nuk respektojnë kushtet e kontratave të lidhura për përdorimin e hapësirës publike në plazh dhe të vlerësojë mundësinë e përfshirjes si element skualifikues historikun negativ në sistemin e vlerësimit të subjekteve që aplikojnë për marrjen e hapësirës publike në plazh në përdorim.

Brenda datë 30.06.2025

Rekomandim 9.3: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në përputhje me kushtet e kontratës model për përdorimin e hapësirës së plazhit/kontratë qiraje, të vlerësojë dhe të marrë masa për zgjidhjen e kontratave kur subjekti nuk ka paguar detyrimin vjetor të qirasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Të ardhurat e vjela nga tarifa e zënies së hapësirës publike në plazhe nuk planifikohen të përdoren në funksion të menaxhimit të tyre në mënyrë direkte, në të gjitha bashkitë subjekt auditimi.

Bashkitë Vlorë, Lezhë, Durrës nuk kanë planifikuar fonde të dedikuara për menaxhimin e hapësirave publike (plazh).

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë ka planifikuar fonde të dedikuara për “mirëmbajtje plazhe publike”:

Në vitin 2022 500.000 lekë

Në vitin 2023 1.200.000 lekë

Në vitin 2024 1.200.000 lekë

Bashkia Shkodër ka planifikuar fonde të dedikuara “Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në plazhe” për vitin 2024 në vlerën 1.500.000 lekë.

Bashkia Himarë ka planifikuar një fond për vendosjen e sinjalistikës në plazhe në vlerë 5.000.000 lekë por nuk e ka realizuar.³⁷

Bashkitë Sarandë, Himarë dhe Shkodër kanë planifikuar fonde të dedikuara për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe, të cilat janë në vlera të papërfillshme dhe të pa shoqëruara me analiza apo preventiva konkrete.

Konkluzion 10: Mungesa e planifikimit të fondeve të dedikuara për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe si edhe mungesa e planifikimit të shpërndarjes së të ardhurave që vilen nga tarifa përkatëse për plazhet, cenojnë menaxhimin e qëndrueshëm të plazheve si një aset me vlerë.

Rekomandim 10.1 Bashkitë Lezhë, Durrës, Vlorë, të kryejnë planifikimin në buxhet për fonde të dedikuara për hapësirat publike në plazhe, në funksion të përmirësimit të kushteve si nga pikëpamja e infrastrukturës ashtu edhe garantimit të standardeve, me projekte konkrete dhe vlera që garantojnë efektivitet në përmbushje të objektivave.

Brenda datë 30.06.2025

Rekomandim 11.1

Bashkitë Shkodër, Himarë, Sarandë, të kryejnë planifikimin në buxhet për fonde të dedikuara për hapësirat publike në plazhe, bazuar në projekte konkrete dhe vlera që garantojnë efektivitet në përmbushje të objektivave.

Brenda datë 30.06.2025

12. Gjetje nga auditimi: Mungon unifikimi i termit çadër shezlongë në faturat tatimore të lëshuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë si stacion plazhi.

Nga të dhënat që administrata tatimore disponon nga sistemi i fiskalizimit i cili përdoret aktualisht për lëshimin e faturave tatimore, rezultojnë artikuj me përshkrime të ndryshme për çadra dhe shezlongë. Subjektet privatë, të cilëve ju jepen hapësira publike në përdorim, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre si stacion plazhi, përdorin emërtim të ndryshëm për të njëjtin artikull (çadër/shezlongë).

Konkluzion 11: Mungesa e unifikimit të emërimit të përdorur nga ana e subjekteve përfituese të hapësirave publike në plazhe, krijon vështirësi për gjenerimin e të dhënave që lidhen me të ardhurat e krijuara nga ky sektor, në sistemin e fiskalizimit pranë administratës tatimore.

Rekomandim 12.1: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për unifikimin dhe përcaktimin e saktë të emërimit që do të përdoret gjatë lëshimit të faturave tatimore nga ana e subjekteve përfituese të hapësirave publike në plazhe, në kontratën që lidhet për këtë qëllim me synim gjenerimin e të dhënave të sakta mbi xhiron e realizuar.

Menjëherë e në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Të dhënat mbi të ardhurat për secilën bashki nga raportet e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit nuk përkojnë me të dhënat e raportuara nga vetë bashkitë. Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk disponojnë të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mbi aktivitetin e subjekteve privatë të cilëve iu jepen në përdorim si stacion plazhi, hapësirat publike në plazhe. Mungesa e të dhënave që

³⁷ Përgjigjet e pyetësorit të fazës së terrenit Bashkia Himarë

lidhen me të ardhurat e realizuara, aktivitetin e subjekteve privatë që përfitojnë hapësira publike në plazhe, etj cenon menaxhimin me efektivitet të plazheve dhe mund të çojë në vendimmarrje të gabuara.

Konkluzion 12: Mungesa e koordinimit të dhënave midis subjekteve të këtij auditimi, mund të çojë në analiza të gabuara dhe jo në shërbim të rritjes së të ardhurave.

Rekomandim 13.1: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me NJVQV-të bregdetare dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të nxisin mekanizma për bashkëpunimin dhe të ngrenë një sistem raportimi periodik mbi të ardhurat e krijuara nga stacionet e plazhit, me qëllim krijimin e një *database* me të dhëna që do ti shërbejnë menaxhimit efektiv të hapësirave publike në plazhe.

Brenda datë 30.06.2025

4.2.3. A është efektiv procesi i monitorimit dhe inspektimit të hapësirave publike në plazhe?

Procesi i inspektimit dhe monitorimit të zonës bregdetare.

AKB-ja ka për mision mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrollin e veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit³⁸.

AKB-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në dy nivele:

në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore

në nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) agjencive rajonale.

1. Agjencia Rajonale e Bregdetit Lezhë (e cila mbuloi zonën nga fshati Adriatik i ish-komunës Fushë/Kuqe i cili ndan me fshatin Ishëm të Durrësit dhe në kufirin verior kufizohet me Lumin Buna, skaji verior i ish-komunës Velipojë).
2. Agjencia Rajonale e Bregdetit Durrës (e cila mbuloi zonën nga Plazhi i Gjirit të Lalzit deri në plazhin e Divjakës (Laguna e Karavastasë), si dhe plazhin e Pogradecit.
3. Agjencia Rajonale e Bregdetit Vlorë (e cila mbuloi zonën nga grykëderdhja e lumit të Semanit (plazhi i Seman) deri në Dhërmi.
4. Agjencia Rajonale e Bregdetit Sarandë (e cila ka kryer monitorimin e të gjithë vijës bregdetare të njohur si Riviera Shqiptare nga Rrugët e Bardha në Palasë deri në Kepin e Stillos, kufiri jugor me Greqinë).

Struktura e miratuar e Agjencive Rajonale të Bregdetit, përgjegjëse për monitorim/inspektimin e zonave bregdetare dhe veprimtarive në turizëm, për periudhën 2024 rezulton si më poshtë:

(Informacioni më i detajuar në tabelën nr. 4 SHTOJCA)

ARB Lezhë

3 specialistë në sektorin e monitorim/inspektimit të zonave bregdetare dhe veprimtarive në turizëm.

ARB Durrës

³⁸ Vendim nr. 569, datë 17.7.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, Kapitulli I, pika 3

4 specialistë në sektorin e monitorim/inspektimit të zonave bregdetare dhe veprimtarive në turizëm.

8 punonjës me kontratë të ngarkuar nga AKB në 2024, VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024.

ARB Vlorë

4 specialistë në sektorin e monitorim/inspektimit të zonave bregdetare dhe veprimtarive në turizëm.

4 punonjës me kontratë të ngarkuar nga AKB në 2024, VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024.

ARB Sarandë

4 specialistë në sektorin e monitorim/inspektimit të zonave bregdetare dhe veprimtarive në turizëm.

1 punonjës me kontratë të ngarkuar nga AKB në 2024, VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024.

Pavarësisht strukturës së miratuar të ARB, gjatë auditimit u evidentuan vende vakante për vitin 2024, si më poshtë vijon:

Agjencia Rajonale e Bregdetit Sarandë 2 vende vakante;

Agjencia Rajonale e Bregdetit Vlorë 1 vend vakant;

Sipas përcaktimit në Vendimin nr. 569, datë 17.7.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”

Agjencia Kombëtare e Bregdetit kryen këto detyra:

- Ushtron kontroll dhe inspekton në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;
- Inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;
- Inspekton dhe kontrollon zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;
- Merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit
- Siguron burimet njerëzore dhe garanton zhvillimin – trajnimin e tyre në përputhje me kërkesat e pozicionit të punës, si dhe kryen vlerësimin e performancës³⁹.

Agjencitë Rajonale të Bregdetit kryejnë këto detyra:

- Ushtron kontroll dhe inspekton në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;
- Inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;
- Inspekton dhe kontrollon zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;
- Merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit

Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi.⁴⁰

³⁹ Vendim nr. 569, datë 17.7.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, Kapitulli III, pika 6

⁴⁰ Vendim nr. 569, datë 17.7.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, Kapitulli III, pika 7

Në Rregulloren e Brendshme të AKB, miratuar me Urdhër nr.153 datë 05.05.2023 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKB”, pasqyrohen të njëjtat detyra si për AKB ashtu edhe për ARB në fushën e inspektimit dhe monitorimit. Megjithëse veprimtaria e ARB është e përcaktuar qartë në fushën e inspektimit, agjencitë rajonale kryejnë vetëm monitorim të zonës bregdetare dhe jo inspektim. Kjo pasi punonjësit, sipas strukturës së institucionit, bazuar në Urdhër nr. 186, datë 15.11.2022 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, nuk gëzojnë statusin “inspektor”.⁴¹

Gjithashtu, në zbatim të ligjit 10433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, inspektorët gëzojnë një status të caktuar, konkretisht: Seksioni 5: Statusi i inspektorit qendror dhe vendor, ku përcaktohet: “Neni 20”

Marrëdhëniet e punësimit të inspektorit

1. Marrëdhëniet e punësimit të inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësit civilë për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Kryeinspektori i inspektoratit përkatës është "eprori i drejtpërdrejtë" i inspektorëve, në kuptimin e këtyre dispozitave.
2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për nëpunësit e tjerë të inspektoratit shtetëror, që nuk janë inspektorë, me përjashtim të punonjësve që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, të cilët u nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

Aktiviteti i ARB gjatë sezonit turistik

Përveç detyrave të mësipërme punonjësit e Agjencive Rajonale të Bregdetit sipas raporteve të AKB, mbikëqyrin edhe dhe procesin e ofrimit të shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, në 7 bashki bregdetare (Shkodër, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë dhe Sarandë), bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 6.12.2023 “Për një shtesë në vendimin nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, të ndryshuar.⁴²

Procesi po mbikëqyret nga punonjësit e AKB-së, gjatë gjithë kohës, në frekuencën e pastrimit 2 herë dhe në fashën orare 18.00-06.00.

Pastrimi i zonës bregdetare, i cili vijon të realizohet për periudhën 15.06.2024 deri në datën 15.09.2024, nga operatori i kontraktuar nga AKB, po kujdeset për:

- Garantimin e ecurisë së procesit pa problematika;
- Sigurimin e nivelit të pastërtisë së zonëve bregdetare, në të cilat do të realizohet.
- Kontejnerë të pastër dhe të klorinuar;
- Sigurimin e pastërtisë së rrugëve që çojnë në zonat e plazhit, veçanërisht të Plazheve Publike.⁴³

AKB, nëpërmjet ARB-ve ndjek edhe procesin e aplikimeve për stacione sezonale ankorimi/bregëzimi, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 29.4.2022 “Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit”, pas miratimit të numrit maksimal të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit, të ndara për secilën bashki, sipas Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe

⁴¹ Përgjigjet e pyetësorit të fazës së terrenit nga AKB, 15.11.2024

⁴² Raport i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për sezonin turistik 2024

⁴³ Raport i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për sezonin turistik 2024, Pastrimi i zonës bregdetare për sezonin turistik veror 2024, pika 9/2, 9/3.

Mjedisit nr. 339, datë 4.11.2022, nr. 7833/2, prot, “Për përcaktimin e numrit maksimal të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit”⁴⁴.

Agjencitë Rajonale të Bregdetit, si pjesë e grupit të punës në Task-Forcën e ngritur me Urdhërin e Prefektit të Qarkut gjatë sezonit turistik, realizojnë edhe monitorimin e vendbazimeve të miratuara si edhe kontrollojnë pajisjen me certifikatë të operatorëve turistikë detar.

14. Gjetje nga auditimi: Agjencitë Rajonale të Bregdetit Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Sarandë, ushtrojnë funksione monitoruese dhe jo funksione inspektuese, sikundër përcaktohet në Vendimin nr. 569, datë 17.7.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” Kapitulli III, pika 7, dhe Rregulloren e Brendshme të AKB, miratuar me Urdhër nr.153 datë 05.05.2023 “Për miratimin e Rregulloreve të Brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKB”.

Strukturat e ngritura të Agjencive Rajonale të Bregdetit janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për të përmbushur misionin për të cilin janë ngritur në fushën e inspektimit dhe monitorimit të zonës bregdetare. Agjencia Rajonale e Bregdetit Sarandë ka 2 vende vakante dhe Agjencia Rajonale e Bregdetit Vlorë 1 vend vakant.

Duke pasur parasysh shtrirjen e zonës territoriale që mbulon secila agjenci rajonale, numrin e punonjësve në sektorët e monitorimit dhe inspektimit të zonave bregdetare, detyrat që duhet të kryejnë sidomos gjatë sezonit turistik, përfshirjen e tyre edhe në procesin e mbikëqyrjes së procesit të pastrimit, ndjekjen e procesit të aplikimeve për stacione sezonale ankorimi/bregëzimi, monitorimin e vendbazimeve të miratuara etj, përdorimi i burimeve njerëzore është jo efektiv.

Konkluzion 13: Pamjaftueshmëria e strukturave të Agjencive Rajonale të Bregdetit dhe mungesa e punonjësve që gëzojnë statusin inspektor pranë tyre, cenon procesin në tërësi si të monitorimit ashtu edhe atë të inspektimit.

Rekomandim 14.1: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të vlerësojë iniciativën për ndryshimin e Vendimit nr. 569, datë 17.7.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” dhe Rregulloreve të Brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKB, në funksion të përmbushjes së misionit për të cilin është ngritur kjo agjenci lidhur me funksionet e monitorimit dhe inspektimit.

Brenda datë 30.06.2025

5. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE

Nëpërmjet shkresës nr. 161 prot. datë 15.01.2025, nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) janë dërguar observacionet për Projekt Raportin e Auditimit.

Referuar rekomandimeve përgjithësisht, AKB shpreh dakordësinë mbi përmbajtjen e rekomandimit dhe bashkëpunimin në vazhdim për përmbushjen e tyre.

Lidhur me rekomandimet e lëna në pyetjen audituese: A janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme masat e marra për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe?

⁴⁴ Raport i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për sezonin turistik 2024, Pastrimi i zonës bregdetare për sezonin turistik veror 2024

Komenti nga AKB:

AKB, vlerëson se: duke pasur parasysh zhvillimin e sektorit të turizmit, edhe masat e që duhet të ndërmerren në mbikëqyrjen e këtij sektori, duhet të jenë të vazhdueshme.

Duke nisur nga sezoni turistik veror 2020, procesi i administrimit të plazheve, lidhur me procedurat për aplikimin dhe miratimin e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit, ka pësuar një sërë ndryshimesh, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171 datë 27.03.2019 "Për miratimin e Rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" (shfuqizuar). Si rezultat i kalimit të shërbimit online, nëpërmjet kalimit të shërbimit në e -Albania, është reduktuar informaliteti, duke mundësuar aplikimin online për marrjen me qira të hapësirës së plazhit, duke bërë përzgjedhjen e subjekteve për lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve sipas strukturave akomoduese të kategorizuara nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para/ në afërsi të strukturës akomoduese/strukturë shërbimi.

Është rritur siguria në plazhe, duke përcaktuar standarde higjienike si dhe është rritur siguria fizike e pushuesve, nëpërmjet rojeve bregdetare. Tashmë çdo subjekt që operon me stacion plazhi, ka të punësuar roje bregdetare të certifikuar.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit gjatë gjithë sezonit turistik është prezent në terren për monitorimin dhe verifikimin e të gjitha veprimtarive turistike të zhvilluara në zonën bregdetare. Tashmë disponohet një data bazë e plotë e subjekteve që operojnë në zonën bregdetare.

Lidhur me **Rekomandim 6.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të rishikojnë kuadrin ligjor dhe rregullator, me synim përfshirjen në procesin e inspektimit edhe NJVQV bregdetare, për të garantuar të drejtën e qytetarëve për akses në plazhe, kundrejt standardeve që duhet të plotësojnë.

Brenda muajit maj 2025

Komenti nga AKB:

Rekomandimi, do të vlerësohet në vijim nga AKB.

Gjithashtu, lutemi, të mbahet parasysh se: për sezonin turistik veror 2025, nga eksperiencia e institucionit në terren, AKB, parashtron nevojën për ndryshime, në raportin e sipërfaqeve plazh publik/zonë e menaxhuar, në funksion të garantimit të plazheve publike, ku sipas gjatësisë në vijë lineare të plazheve, të përcaktohet në çdo 1 km vijë lineare, 300 m linear plazh, e cila do të shërbejë si parcelë publike, sipas tipologjisë së plazheve dhe vendosjes së tyre në terren, veçanërisht në pjesën e zonave urbane, ku ka prani të lartë dhe të zonave apo komplekseve të banimit, duke qenë se janë dhe objekti kryesor i kërkesave për rritje të sipërfaqes së plazheve publike.

Me rregulloren e re të plazheve, për sezonet turistike në vijim, konkretisht VKM Nr. 649, datë 16.10.2024, për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", ka ndryshuar parashikimi për plazhet publike, me qëllim rritjen e këtyre sipërfaqeve, ku aktualisht përcaktohet:

Neni 4

Harta e përgjithshme për plazhet e lejuara

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara.
3. Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar, si plazh privat/publik, do të kryhet sipas gjatësisë në vijë lineare të hartës së propozuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në mënyrë perpendikulare me vijën e bregut të detit/liqenit, ku në çdo 1000 m vijë lineare, 300 m vijë linear plazh përcaktohen si parcela publike, shpërndarja e të cilave në hartë vlerësohet nga njësia e qeverisjes vendore, rast pas rasti, sipas tipologjisë së secilit plazh.

Neni 5

Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik

Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (në vijim "KMST"), ka si detyrë: miratimin e listës së plazheve dhe hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat pajisen me një numër të veçantë identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së kërkesës on-line;

Qëndrimi i grupit të auditimit: Komenti i paraqitur nga AKB, nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rekomandimin e lënë.

Lidhur me **Rekomandim 9.2:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa krijimin e një data basë të subjekteve të cilët nuk respektojnë kushtet e kontratave të lidhura për përdorimin e hapësirës publike në plazh dhe të vlerësojë mundësinë e përfshirjes si element s'kualifikues historikun negativ në sistemin e vlerësimit të subjekteve që aplikojnë për marrjen e hapësirës publike në plazh në përdorim.

Brenda muajit qershor 2025

Komenti AKB:

Rekomandimi do të vlerësohet në vijim nga AKB, ndërsa kriteret që duhet të përmbushë një subjekt për ushtrimin e veprimtarisë së plazhit, përcaktohen me Rregullore të veçantë.

Lidhur me **Rekomandim 9.3:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në përputhje me kushtet e kontratës model për përdorimin e hapësirës së plazhit/kontratë qiraje, të vlerësojë dhe të marrë masa për zgjidhjen e kontratave kur subjekti nuk ka paguar detyrimin vjetor të qirasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti AKB:

AKB, ka pasur vetëm një rast në Bashkinë Himarë, subjekt, i cili nuk ka shlyer detyrimin e qirasë për sipërfaqen e plazhit, për të cilin ka vijuar menjëherë me zgjidhjen e kontratës së plazhit.

Megjithatë, në zbatim të rekomandimit, AKB ka kërkuar nga Bashkitë bregujore, me shkresën nr. 139 prot. datë 14.01.2025, informacion nëse ka subjekte, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet pranë njësisë vendore, si institucione përfutuese të të ardhurave të plazhit, referuar pagesës së sipërfaqes së stacionit të plazhit.

Aktualisht i referohemi subjekteve që disponojnë një kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit, në fuqi.

Nëse do të ketë subjekte që nuk kanë shlyer detyrimet, nga ana e AKB-së, do të vijohet me zgjidhjen e kontratave të plazhit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Komenti i paraqitur nga AKB nuk argumenton mos pranimin e tij.

Lidhur me **12.Gjetje nga auditimi:** Mungon unifikimi i termit çadër shezlongë në faturat tatimore të lëshuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë si stacion plazhi. Nga të dhënat që administrata tatimore disponon nga sistemi i fiskalizimit i cili përdoret aktualisht për lëshimin e faturave tatimore, rezultojnë artikuj me përshkrime të ndryshme për çadra dhe shezlongë. Subjektet privatë, të cilëve ju jepen hapësira publike në përdorim, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre si stacion plazhi, përdorin emërtim të ndryshëm për të njëjtin artikull (cadër/shezllon). Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për gjenerimin e të dhënave që ju vunë në dispozicion auditimit, u krye kërkimi për artikull nëpërmjet fjalëve kyçe: cader, çader, cadër, çadër, shezllone, shazllone, shezlon, cadra, çadra, gazebo, umbrella, të gjitha këto emërtime të përdorura nga subjektet tatimpaguese. Nga administrata tatimore konfirmohet se mundet të ketë edhe fjalë të tjera të përdorura nga ana e tatimpaguesve për artikullin çadër/shezllone.

Rekomandim 12.1: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për unifikimin dhe përcaktimin e saktë të emërtimeve që do të përdoret gjatë lëshimit të faturave tatimore nga ana e subjekteve përfituese të hapësirave publike në plazhe, në kontratën që lidhet për këtë qëllim me synim gjenerimin e të dhënave të sakta mbi xhiron e realizuar.

Menjëherë e në vijimësi

Komenti AKB:

Zbatimi i rekomandimit nuk është pjesë e kompetencave të institucionit, megjithatë Agjencia Kombëtare e Bregdetit, do të përcjellë këtë rekomandim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të vlerësuar metodikën apo formën për zbatimin e tij.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi i lënë për unifikimin e emërtimeve i është referuar faktit se AKB është institucioni i cili lidh kontratat me subjektet përfituese të hapësirave publike dhe si e tillë mund të ndërmarrë iniciativën për përcaktimin saktë të emërtimeve që do të përdoret në bashkëpunim me DPT.

Lidhur me **Rekomandim 15.1:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të vlerësojë iniciativën për ndryshimin e Vendimit nr. 569, datë 17.7.2019 "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKB, në funksion të përmbushjes së misionit për të cilin është ngritur kjo agjenci.

Brenda muajt mars 2025

Komenti AKB:

Rekomandimi do të vlerësohet në vijim nga AKB.

Sjellim në vëmendje se, me ndryshimet ligjore të Ligjit nr. 99/2024 datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", AKB do të riorganizohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, si pasojë e ndryshimeve të kompetencave mbi funksionet monitoruese, inspektuese dhe kontrolluese të veprimtarive turistike.

Në momentin e shkëputjes së inspektoratit, AKB në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit do të marrë masa për iniciimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 569/ 2019, si dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit, duke marrë në konsideratë dhe rekomandimin e KLSH-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Komenti i paraqitur nga AKB nuk argumenton mos pranimin e tij.

Pamje të plazheve publike

Foto 3. Plazhi publik Sarandë



Foto 4. Plazhi publik Sarandë



Foto 5. Pamje nga plazhi publik Pashaliman



Foto 6. Plazhi publik Durrës(Vollga)



Foto 7. Plazhi publik Golem



Foto 8 Zaptimi i hapësirës publike në plazhin e Golemit nga qytetarët



Foto 9 Zaptimi i hapësirës publike në plazhin e Golemit nga qytetarët



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT